
Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Raporti për Shqipërinë
2025



Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Raporti për Shqipërinë 2025

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Shtator, 2026

Co-funded by the European Union

Botues: Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Autore: Kostandina Këruti

Klotilda Kosta

Juliana Hoxha

Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Adresa: Rruga Macedonia 43-1/9, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Telefon: +389 2 6144 211

Email: executiveoffice@balkancsd.net

Faqje interneti: www.balkancsd.net

www.monitoringmatrix.net

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Adresa: Rruga e Elbasanit, Pallati Park Gate, Kati 10, Ap. 71/73, Tiranë, Shqipëri

Telefon: 00355 4 2254 881

Email: partners@partnersalbania.org

info@resourcecentre.al

Faqje interneti: www.partnersalbania.org

www.resourcecentre.al

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Tiranë, Shqipëri 2026

Versioni elektronik është i disponueshëm në faqen e internetit të Partnerëve Shqipëri: www.partnersalbania.org, në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri: www.resourcecentre.al, në faqen e internetit të BCSDN-së: www.balkancsd.net si dhe në: http://www.monitoringmatrix.net

Ky raport është pjesë e projektit "Western Balkans Civil Society Development Hub" financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida) dhe zbatuar nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, në bashkëpunim me organizatat anëtare nga Ballkani Perëndimor. Ai është gjithashtu pjesë e aktiviteteve të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Lëvizjen Evropiane në Shqipëri. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe interpretimet e Sida-s apo qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

Mirënjohje 7

Përmbledhje Ekzekutive 9

Vështrim i Përgjithshëm mbi Shoqërinë Civile 12

Gjetjet kryesore 13

Rekomandimet kryesore 14

Hyrje 15

Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive 18

1.1. Liria e organizimit 18

1.2. Liritë e tjera 24

Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare të OJF-ve 29

2.1. Trajtimi tatimor/ fiskal për OJF-të dhe donatorët e tyre 29

2.2. Mbështetja e shtetit 31

2.3. Kapitali njerëzor 40

Fusha 3: Marrëdhënia Shtet - OJF 43

3.1. Kuadri Ligjor dhe Praktik për Bashkëpunim 43

3.2. Përfshirja në proceset politike dhe vendimmarrje 45

3.3. Bashkëpunimi në Sigurimin e Shërbimeve 50

Bibliografia 54

Aneks 60

Shkurtime

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
AKR	Agjencia Kombëtare e Rinisë
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
BCSDN	Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile
BE	Bashkimi Evropian
DPT	Drejtoria e Përgjithshme Tatimore
FATF	Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar
FT	Financimi i Terrorizmit
KiE	Këshilli i Evropës
KKIE	Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian
KKSHC	Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile
MD	Ministria e Drejtësisë
MM	Matrica e Monitorimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
OJF	Organizata Jofitimprurëse
PPIE	Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian
PPP	Parandalimi i Pastrimit të Parave
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
VF	Viti Fiskal

Mirënjohje

Raporti “Matrica e Monitorimit për Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – Raporti për Shqipërinë 2025” u përgatit nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, falë bashkëpunimit dhe kontributeve të çmuara të organizatave jofitimprurëse (OJF), institucioneve publike, institucione financiare, grupeve informale nga e gjithë Shqipëria.

Partnerët Shqipëri shpreh mirënjohjen e saj për drejtuesit ekzekutivë, menaxherët e lartë dhe përfaqësuesit e OJF-ve pjesëmarrëse, si dhe për përfaqësuesit e sektorit bankar, grupeve informale dhe të paregjistruara, dhe ekspertëve, të cilët, me bashkëpunimin dhe kontributin e tyre, bënë të mundur përgatitjen e këtij raporti. Rreth 80 pjesëmarrës kontribuuan në këtë raport përmes intervistave të thelluara dhe tre grupeve tematike të fokusit, të cilat trajtuan përvojat e grupeve informale dhe të paregjistruara, çështjet gjinore dhe llogaridhënien në ofrimin e mbështetjes financiare.

Partnerët Shqipëri shpreh gjithashtu mirënjohjen e saj për përfaqësuesit e institucioneve publike, të cilët iu përgjigjën kërkesave për informacion, morën pjesë në intervista dhe ofruan të dhëna që pasuruan dhe mbështetën në mënyrë të konsiderueshme analizën e paraqitur në këtë raport.

Së fundmi, falenderojmë kolegët e Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) për orientimin dhe mbështetjen e tyre.

Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë periudhës 2025–2026, në Shqipëri u miratuan një numër i madh aktesh ligjore të nxitura nga procesi i anëtarësimit në BE. Konsultimi publik, shqyrtimi dhe reflektimi i komenteve dhe rekomandimeve të paraqitura gjatë këtij procesi, si dhe ndërmarrja e veprimeve institucionale për zbatimin e legjislacionit, nuk ecën me të njëjtin ritëm me procesin e miratimit. Kjo pasqyrohet në të tria fushat e matricës së monitorimit.

Adresimi i problematikave mbi kuadrin ligjor për lirinë e organizimit nuk u realizua në kohën e duhur. Ndryshimet në ligjin nr. 80/2021, "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", të cilat synonin zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, u miratuan në dhjetor 2025, rreth dy vite pas dhënies së vendimit. Megjithatë, problematika lidhur me proporcionalitetin e gjobave mbeti ende e pa adresuar. Deri më 26 shkurt 2026, Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, publikoi në faqen e saj të internetit një listë të organizatave jofitimprurëse.[1] Në formën e saj aktuale, kjo listë nuk përmbush funksionet e një regjistri elektronik plotësisht funksional. Së pari, lista nuk pasqyron në mënyrë të plotë organizatat e regjistruara, ndërsa mbetet e paqartë shkalla në të cilën ajo mund të përdoret në praktikë. Së dyti, informacioni i publikuar është minimal dhe ofron pak të dhëna për organizatat e regjistruara. Gjithashtu, ndërfaqja nuk mundëson filtrimin, renditjen apo kërkimin e të dhënave për të lehtësuar qasjen në informacion.

Në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në prill 2026, ndryshimet në kuadrin ligjor përfshinë kategorinë e organizatave jofitimprurëse "*që konsiderohen me rrezik të lartë"*, pa përcaktuar se cili autoritet e bën këtë klasifikim dhe mbi çfarë baze. Ky formulim nuk përputhet me qasjen e bazuar në rrezik dhe në parimin e proporcionalitetit të Rekomandimit 8 të FATF-së dhe mbart rrezikun e interpretimit subjektiv dhe të dëmtimit reputacional të OJF-ve.

Sa i përket lirisë së shprehjes, në janar 2026 u miratua një paketë ndryshimesh ligjore, që nuk e dekriminalizoi plotësisht shpifjen. Mbrojtja e parashikuar nga ndryshimet ligjore u kufizua vetëm te gazetarët "e regjistruar" ose "të njohur", duke përjashtuar aktivistët, OJF-të dhe publikun e gjerë. Ky kufizim evidenton mangësi në përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në përafrimin e kuadrit ligjor me standardet e BE-së. Në lidhje me narrativën publike ndaj OJF-ve, Urdhri për Pezullimin, i lëshuar nga administrata amerikane më 20 janar 2025, u pasua nga shtimi i skepticizmit dhe retorikës kritike ndaj OJF-ve, veçanërisht ndaj atyre që punojnë në fushën e të drejtave e njeriut, barazinë gjinore dhe të drejtat e personave LGBTIQ+. Pezullimi i ndihmës së huaj u shfrytëzua nga disa aktorë politikë dhe mediatikë për të vënë në pikëpyetje legjitimitetin, pavarësinë dhe transparencën e OJF-ve që përfitojnë financim nga burime të huaja. Këto organizata u paraqitën si të ndikuara nga interesa të jashtme ose të motivuara politikisht. Narrativat e tilla u përhapën dhe u amplifikuan përmes platformave online dhe një pjese të mediave, duke nxitur dezinformimin, cënuar reputacionin e organizatave

[1] Informacioni gjendet në faqen e internetit të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tirana. I disponueshëm: https://gjykata.gov.al/rrethi-tiran%C3%AB/gjykata-e-shkLekë%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-tiran%C3%AB/regjistri-elektronik-ojf/

dhe kontribuar në krijimin e një klime më armiqësore ndaj OJF-ve që angazhohen në advokim dhe mbrojtjen e interesit publik.

Financimi publik i sektorit jofitimprurës ka qenë tradicionalisht i pamjaftueshëm në raport me nevojat e tij. Tërheqja e donatorëve bilateral dhe reduktimi i ndihmës së huaj thelluan sfidat e qendrueshmërisë financiare, duke rrezikuar vazhdimësinë e shumë shërbimeve të ofruara nga OJF-të, si dhe kontributin e sektorit në zhvillimin social, ekonomik dhe demokratik të vendit. Në vitin 2025, vetëm 75 nga rreth 2,412 OJF aktive,[2] ose afërsisht 3,1%, përfituan financim nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, ndërsa financimi nga ministritë zakonisht kufizohet në një maksimum prej 50% të kostove të pranueshme.

Për sa i përket lehtësirave tatimore, një zhvillim pozitiv në vitin 2025 ishte miratimi i Udhëzimit nr. 6, datë 24.02.2025, që ndryshon Udhëzimin nr. 6, datë 30 janar 2015, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë". Dispozitat e ndryshuara qartësojnë procedurat për zbatimin e përjashtimit të TVSH-së për marrëveshjet e granteve të financuara në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe qeverive të huaja, të ratifikuara nga Kuvendi. Gjithashtu, sipas informacionit të publikuar nga SASPAC, po punohet për të mundësuar kryerjen përmes portalit e-Albania të procesit të aplikimit për përjashtimin nga TVSH-ja për projektet e financuara nga burime të huaja. Kjo do të thjeshtonte më tej procedurën. Përjashtimi tashmë zbatohet në praktikë dhe adreson një shqetësim të vazhdueshëm të OJF-ve lidhur me paqartësitë administrative në trajtimin e TVSH-së. Ky ndryshim sjell më shumë qartësi dhe lehtëson procedurat, por zbatimi i tij efektiv kërkon që institucionet përkatëse ta zbatojnë në mënyrë të njëtrajtshme dhe të sigurojnë informimin e duhur të aktorëve të përfshirë.

Bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe OJF-ve vijoi të karakterizohej nga mangësi në strukturimin, koordinimin dhe qëndrueshmërinë e tij. Kjo situatë lidhej, ndër të tjera, me mungesën e dokumenteve strategjike dhe mekanizmave funksionalë që do të mbështesnin dhe lehtësonin një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe efektiv. Aktualisht, nuk ekziston një strategji e dedikuar për zhvillimin e sektorit të OJF-ve. Periudha e zbatimit të Udhërrëfyesit për Politikën e Qeverisë drejt një Mjedisi më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019–2023 përfundoi me një shkallë të ulët të zbatimit të objektivave të përcaktuara. Megjithëse pritej hartimi dhe miratimi i një dokumenti të ri strategjik, ai ende mungon, edhe pse ka kaluar më shumë se dy vjet pas përfundimit të Udhërrëfyesit. Për rrjedhojë, mungojnë drejtimet e qarta për zhvillimin e sektorit të OJF-ve, bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe monitorimin e progresit.

Një nga sfidat kryesore mbetet përfshirja e OJF-ve në proceset e konsultimit publik dhe hartimit të politikave. Në shumë raste, konsultimi zhvillohet vetëm pasi projekt aktet janë hartuar, duke kufizuar mundësinë e OJF-ve për të kontribuar që në fazat e para në identifikimin e problematikave dhe përcaktimin e prioriteteve. Si rezultat, konsultimi publik shpesh mbetet formal dhe nuk siguron përfshirjen e duhur të OJF-ve në proceset vendimmarrëse. Kjo problematikë thellohet nga procedurat e përshpejtuara të miratimit të ligjeve, të cilat kufizojnë afatet e konsultimit publik ose e anashkalojnë atë. Ndonëse procedurat urgjente mund të jenë të justifikuara në rrethana të jashtëzakonshme, përdorimi i tyre i përsëritur zbeh transparencën dhe kufizon mundësitë e shoqërisë civile për të dhënë kontribute të mbështetura në të dhëna dhe fakte. Edhe për Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian, e cila synon të lehtësojë dialogun ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile, informacioni mbi veprimtarinë, anëtarësinë dhe rezultatet e saj mbetet i kufizuar.

[2] INSTAT, 2026 "Regjistrat e Biznesit". I disponueshëm: https://www.instat.gov.al/media/2hololz3/tab-1-nj%C3%ABsi-ligjore-aktive-sipas-form%C3%ABs-ligjore.xlsx

Po ashtu, mungon informacioni mbi masën në të cilën rekomandimet e shoqërisë civile ndikojnë në qëndrimet negociuese dhe në reformat që lidhen me procesin e anëtarësimit në BE. Kjo mungesë transparence e vështirëson vlerësimin e rregullsisë dhe përfaqësimit të pjesëmarrjes, si dhe kufizon llogaridhënien publike për një nga proceset më kryesore të politikëbërjes në vend.

Vështrim i Përgjithshëm mbi Shoqërinë Civile

	2024	2025
Numri i organizatave të regjistruara	13,053 OJF 284 të regjistruara në vitin 2024	13,300 OJF 246 organizata të regjistruara 2025
Ligjet kryesore për shoqërinë civile	Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 8788/2001 "Për organizatat jofitimprurëse". Ligji nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse"	
Ndryshimet përkatëse në kuadrin ligjor	Projektligji "Për vullnetarizmin" VKM nr. 611, datë 2.10.2024, "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike"	Ligji nr. 82/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", i ndryshuar Udhëzimi nr. 6, datë 24.02.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015, 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë'"
Financimi publik	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile: 96,5 milionë Lekë (rreth 968 150 Euro)	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile: 107 milionë Lekë (rreth 1,12 milionë Euro)
Burimet njerëzore (punonjës dhe vullnetarë)	9,875 punonjës, nga të cilët 8, 916 me kohë të plotë dhe 959 me kohë të pjesshme. Nuk ka të dhëna të disponueshme për vullnetarët.	Nuk ka të dhëna të disponueshme për numrin e punonjësve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme në sektor. Nuk ka të dhëna të disponueshme për vullnetarët.
Bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë (organi përkatës/mekanizmi i konsultimit)	Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile. Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian. Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian.	
Sfidat kryesore	Procedura joefektive për përjashtimin nga TVSH-ja të granteve të huaja. Vështirësi në sigurimin e të dhënave të sakta dhe në kohë për sektorin e OJF-ve. Mosfunksionimi i regjistrit elektronik të OJF-ve.	Mungesa e konsultimit efektiv me OJF-të. Mosfunksionimi i regjistrit elektronik të OJF-ve. Mungesa e të dhënave të besueshme për OJF-të.

Gjetjet kryesore

1	Regjistri elektronik i OJF-ve, i parashikuar në ligjin nr. 80/2021 për t'u vënë në funksion deri më 30 dhjetor 2023, mbetet ende i pazbatueshëm. Në shkurt 2026, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë publikoi në faqen e saj të internetit vetëm një listë të pjesshme, e cila nuk mundëson kërkimin, filtrimin apo renditjen e të dhënave për OJF-të. Gjatë vitit 2025, koha mesatare e regjistrimit në Gjykatë ishte 90 ditë, kundrejt afatit ligjor prej 15 ditësh.
2	Financimi publik për sektorin mbetet i fragmentuar dhe kryesisht i orientuar drejt mbështetjes së projekteve. Nuk ka një shifër të konsoliduar për financimin e përgjithshëm publik të OJF-ve, pasi fondet shpërndahen përmes Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe ministrive të ndryshme të linjës, pa një sistem të unifikuar financimi. Nuk ekziston një skemë e posaçme për financimin institucional apo mbulimin e kostove bazë të organizatave, ndërsa financimi publik për shërbimet sociale të ofruara nga OJF-të vlerësohet thuajse i munguar. Si rezultat, financimi i organizatave vijon të mbështetet kryesisht te donatorët e huaj, mbështetja financiare e të cilëve është gjithnjë e më e kufizuar.
3	Aktualisht, nuk ka një strategji të posaçme qeveritare për sektorin jofitimprurës. Zbatimi i Udhërrëfyesit për Politikën e Qeverisë drejt një Mjedisi më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019–2023 përfundoi me një shkallë të ulët realizimi të objektivave dhe, më shumë se dy vite pas përfundimit të tij, ende nuk është miratuar një dokument i ri strategjik. Ndërkohë, Udhërrëfyesi për Funksionimin e Institucioneve Demokratike përmban masa që lidhen me shoqërinë civile, por mungon një raport publik mbi zbatimin e tyre. Gjithashtu, informacioni i siguruar përmes kërkesave për të drejtë informimi nuk shoqërohet me dokumentacion mbështetës që të mundësojë verifikimin e tij.
4	Konsultimi publik vijon të ketë problematika në praktikë. Problemet teknike të platformës elektronike kanë vështirësuar aksesin dhe paraqitjen e komenteve nga palët e interesit. Për projektligjet e Grupkapitullit të Parë “Themeloret”, konsultimet janë zhvilluar në faza të vona, duke kufizuar mundësinë për të ndikuar në përmbajtjen e tyre. Ndërkohë, raportet përmbledhëse nuk publikohen rregullisht dhe shpesh nuk sqarojnë nëse komentet janë pranuar apo refuzuar.

Rekomandimet kryesore

1	Të përshpejtohet operacionalizimi i plotë i regjistrit elektronik të OJF-ve, përmes përcaktimit të një afati konkret për përfundimin e procesit dhe publikimit të raporteve periodike mbi ecurinë e tij, duke pasur parasysh vonesën e konsiderueshme në raport me afatin ligjor të përcaktuar për vitin 2023.
2	Të unifikohet raportimi i të gjitha institucioneve që financojnë OJF-të përmes një burimi të vetëm, të përditësuar rregullisht, si dhe të krijohet një mekanizëm i posaçëm për financimin institucional dhe mbulimin e kostove bazë të organizatave, me qëllim uljen e varësisë nga financimi i bazuar në projekte dhe nga donatorët e huaj.
3	Të miratohet një dokument i ri strategjik në vijim të Udhërrëfyesit për Politikën e Qeverisë drejt një Mjedisi më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019–2023. Gjithashtu, raportimi mbi zbatimin e masave të Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike të bazohet në të dhëna publike, të shoqëruara me metodologji të qartë dhe transparente.
4	Të garantohet përfshirja e palëve të interesit që në fazat e hershme të procesit të konsultimit dhe të kërkohet nga institucionet publikimi i përgjigjeve të argumentuara për komentet e marra, në mënyrë që kontributet e tyre të reflektohen në vendimmarrje.

Hyrje

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim ka kënaqësinë të prezantojë edicionin e 13-të të raportit "Matrica e Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – Raporti për Shqipërinë 2025". Raporti pasqyron zhvillimet gjatë vitit 2025 dhe përfshin edhe disa zhvillime të rëndësishme të fillim vitit 2026, për të ofruar një panoramë më të plotë dhe të përditësuar.

Ky raport është pjesë e një serie raportesh kombëtare që mbulojnë gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë), si dhe Turqinë. Gjithashtu, është i disponueshëm një raport rajonal që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për të gjitha vendet, si dhe një platformë interaktive në internet që mundëson aksesin në të dhënat e monitorimit për secilin vend në www.monitoringmatrix.net.

Matrica e Monitorimit, e hartuar në vitin 2013 nga BCSDN-ja me mbështetjen e anëtarëve dhe partnerëve të saj, paraqet parimet dhe standardet kryesore që konsiderohen thelbësore për një mjedis mundësues për veprimtarinë e OJF-ve. Matrica është e organizuar në tri fusha, secila e ndarë në nën-fusha:

- Garancitë themelore ligjore të lirive;
- Kuadri për qëndrueshmërinë financiare të organizatave të shoqërisë civile;
- Marrëdhënia ndërmjet shtetit dhe organizatave të shoqërisë civile.

Metodologjia gjithëpërfshirëse mbështetet në standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira rregullatore të Bashkimit Evropian dhe vendeve evropiane. Matrica e Monitorimit synon të përcaktojë kushtet optimale për funksionimin dhe zhvillimin efektiv të shoqërisë civile, duke ofruar një kuadër që autoritetet publike mund të ndjekin dhe zbatojnë. Duke pasur parasysh se sfidat kryesore lidhen me zbatimin, janë përcaktuar 139 tregues për të monitoruar kuadrin ligjor ekzistues dhe zbatimin e tij në praktikë.

Matrica e Monitorimit ndjek një cikël vjetor raportimi, duke mundësuar vlerësime sistematike dhe të krahasueshme ndërmjet vendeve të rajonit dhe në kohë. Ky proces i ndihmon palët e interesuara të ndjekin përparimin ose regresin, të identifikojnë mangësitë dhe prirjet e reja, si dhe të përcaktojnë përparësitë për reforma. Kërkimi synon të mbështesë raportimin alternativ mbi mjedisin mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile dhe të ndikojë në politikën e zgjerimit dhe financimin e Bashkimit Evropian, për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm dhe strategjik të sektorit.

Konteksti

Gjatë vitit 2025, zhvillimet në shoqërinë civile u ndikuan nga dinamika politike dhe institucionale e lidhur me zgjedhjet parlamentare dhe përparimin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në zgjedhjet parlamentare të 11 majit, Partia Socialiste fitoi mandatin e katërt qeverisës radhazi, ndërsa shtetasit shqiptarë me banim jashtë vendit patën për herë të parë mundësinë të votonin nga jashtë vendit. Sipas OSBE/ODIHR-it, zgjedhjet ishin konkurruese dhe u administruan me profesionalizëm, por u zhvilluan në një klimë të theksuar polarizimi, ku subjektet zgjedhore garuan në kushte të pabarabarta. Partia në pushtet përfitoi nga burimet administrative dhe ndikimi i institucioneve, ndërkohë që u raportuan pretendime për presion ndaj zgjedhësve, veçanërisht ndaj punonjësve të sektorit publik. Përqendrimi i pronësisë së mediave, ndërhyrjet në autonominë editoriale, ndikimi politik dhe autocensura e gazetarëve kufizuan më tej shumëllojshmërinë e informacionit që u ofrohej zgjedhësve.[3] Monitorimi i pavarur nga organizatat vendase të shoqërisë civile pati rëndësi të veçantë në monitorimin e zgjedhjeve. Megjithatë, mungesa e financimit të mjaftueshëm, veçanërisht nga donatorët ndërkombëtarë, kufizoi mundësitë e OJF-ve për të realizuar një vëzhgim gjithëpërfshirës dhe për të siguruar mbikëqyrje më të plotë të procesit zgjedhor.[4]

Në të njëjtën kohë, Shqipëria shënoi përparim të mëtejshëm në negociatat për anëtarësim në BE. Gjatë vitit 2025, deri në nëntor, u hapën negociatat për katër grupkapituj të tjerë,[5] megjithëse ende nuk është mbyllur asnjë kapitull.[6] Përshpejtimi i procesit të anëtarësimit rriti vëllimin dhe ritmin e reformave ligjore, politike dhe institucionale të nevojshme për përafrimin e kuadrit kombëtar me legjislacionin e BE-së. Megjithatë, ky përshpejtim nuk u shoqërua me një pjesëmarrje më kuptimplotë të shoqërisë civile. Vëllimi i madh i legjislacionit të lidhur me procesin e anëtarësimit në BE, si dhe afatet e shkurtra për hartimin dhe miratimin e tij, kufizuan mundësitë e OJF-ve për të shqyrtuar në mënyrë të plotë propozimet ligjore dhe për të përgatitur rekomandime të mbështetura në të dhëna dhe fakte. Komisioni Evropian theksoi se procesi i integrimit në BE duhet të jetë më gjithëpërfshirës dhe të mbështetet në mekanizma efektivë konsultimi. Ai vuri në dukje se konsultimet publike mbeten të kufizuara dhe se pas konsultimeve parlamentare nuk jepej rregullisht informacion në kohë dhe në mënyrë transparente mbi trajtimin e kontributeve të marra. Gjithashtu, kërkoi që të nxitej më tej pjesëmarrja e shoqërisë civile në konsultimet e zhvilluara nga qeveria.[7]

Rritja ekonomike, zgjerimi i turizmit dhe digjitalizimi i mëtejshëm i shërbimeve publike krijuan mundësi zhvillimi gjatë vitit. Megjithatë, emigracioni, rënia e popullsisë, pabarazitë ndërmjet rajoneve, cenueshmëria sociale dhe aksesi i pabarabartë në shërbime mbetën shqetësime të rëndësishme.[8] Rritja e treguesve makroekonomikë nuk

[3] Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (2025). *Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 — Raporti përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve*, f. 2–4 dhe 22–25. I disponueshëm: https://odihr.osce.org/sites/default/files/documents/official_documents/2026/05/ALB%20Parliamentary%202025%20Final%20Report_23.10.2025.pdf

[4] Ibid. fq. 27

[5] Tregu i Brendshëm në prill, Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse në maj, Agjenda e Gjelbër dhe Lidhshmëria e Qëndrueshme në shtator, si dhe grupimi i Burimeve, Bujqësisë dhe Kohezionit në nëntor.

[6] Këshilli i Bashkimit Evropian. (2025). *Takimi i shtatë i Konferencës së Anëtarësimit me Shqipërinë në nivel ministror, 17 nëntor 2025*. Shih gjithashtu: Komisioni Evropian. (2025). *Raporti për Shqipërinë 2025*, f. 3–4 dhe 93–95. I disponueshëm: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf

[7] Komisioni Evropian. (2025). *Raporti për Shqipërinë 2025*, Dokument pune i shërbimeve të Komisionit, SWD (2025) 750 final. I disponueshëm: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf

[8] Ibid, fq. 14, 40–42 dhe 54–57

solli shpërndarje të barabartë të mirëqenies në të gjitha shtresat e popullsisë dhe zonat gjeografike. Ndërkohë, mangësitë në ofrimin e shërbimeve sociale, arsimore dhe të tjera publike vijuan të preknin veçanërisht grupet në nevojë dhe komunitetet në zonat jashtë qendrave kryesore urbane. Komisioni Evropian evidentoi gjithashtu probleme të vazhdueshme strukturore në tregun e punës, mangësi në aftësitë profesionale dhe nevojën për të garantuar akses të barabartë në shërbimet publike që po digjitalizohen gjithnjë e më shumë, veçanërisht për grupet në nevojë.[9]

Në këtë kontekst, OJF-të vijuan të ofronin shërbime, të përfaqësonin komunitetet, të mbështesnin reformat me ekspertizën e tyre dhe të ushtronin monitorim të pavarur ndaj institucioneve publike. Megjithatë, fondet e kufizuara, varësia nga financimi përmes projekteve, bashkëpunimi i paqëndrueshëm me institucionet, ngarkesa administrative dhe problematikat lidhur me hapësirën qytetare cenuan qëndrueshmërinë e tyre. Këto vështirësi kufizuan edhe mundësitë për angazhim të vazhdueshëm në politikëbërje, monitorim afatgjatë dhe ofrim të pandërprerë të shërbimeve.

[9] Ibid, fq. 8–9, 24, 26 dhe 56–57.

Gjetjet

Fusha 1: **Garancitë Themelore Juridike të Lirive**

1.1. Liria e organizimit

1.1.1. Liria për të Themeluar dhe për të marrë Pjesë në OJF

Kuadri ligjor për lirinë e organizimit është përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, [10] ligji nr. 8788/2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar,[11] dhe ligji nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", i ndryshuar,[12] rregullojnë të gjithë ciklin e veprimtarisë së organizatave jofitimprurëse (OJF-ve), përfshirë themelimin, regjistrimin, funksionimin, drejtimin dhe shpërndarjen e tyre. Personat fizikë dhe juridikë mund të themelojnë shoqata, fondacione dhe qendra për çdo qëllim të ligjshëm, pa ndeshur diskriminim. Të njëjtat garanci zbatohen edhe për shtetasit e huaj, pasi Kushtetuta parashikon se të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e përcaktuara për shtetasit shqiptarë, vlejnë njëlloj edhe për ta, përveç rasteve kur Kushtetuta e lidh shprehimisht ushtrimin e të drejtave dhe lirive të caktuara me shtetësinë shqiptare. Gjithashtu, regjistrimi i OJF-ve nuk është i detyrueshëm. Kur organizatat zgjedhin të regjistrohen, kuadri ligjor parashikon procedura të qarta për regjistrim.

Në dhjetor 2025, ligji për regjistrimin e OJF-ve u ndryshua për të reflektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese të nëntorit 2023,[13] i cili shfuqizoi dispozitat që lidhen me regjistrimin fillestar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 30 ditëve, disa kompetenca të kancelarit dhe vendosjen e sanksioneve administrative. Ndryshimet ligjore u miratuan me rreth dy vjet vonesë.[14] Megjithatë, sanksionet administrative mbeten përsëri shqetësuese në ligjin e miratuar. Ai parashikon sanksione administrative që mbivendosen me ato të përcaktuara në legjislacionin ekzistues, duke krijuar pasiguri ligjore dhe rrezikun që OJF-të të ndëshkohen dy herë për të njëjtën shkelje. Ai parashikon gjoba deri në 60,000 Lekë (rreth 625 Euro) për paraqitjen e informacionit të pasaktë ose mosraportimin e ndryshimeve brenda afateve të përcaktuara. Gjatë konsultimit për ndryshimet ligjore në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, OJF-të ngritën shqetësime mbi proporcionalitetin e sanksioneve administrative të propozuara. Megjithatë, këto shqetësime nuk u morën parasysh në ndryshimet përfundimtare.

[10] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. I disponueshëm: https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd
[11] Fletore Zyrtare 28/2001, Ligji Nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar. I disponueshëm:
[12] Fletore Zyrtare 121/2021, Ligji 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse". I disponueshëm: https://qbz.gov.al/share/w3e6ZV2nR76t_BQFHt-CXw
[13] Fletore Zyrtare 62/2023. I disponueshëm: https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/11/20/62/54732040-bf13-412e-8d47-09b1736264d6
[14] Vendimi i Gjykatës Kushtetuese u publikua në Fletoren Zyrtare nr. 5/2024. I disponueshëm: https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/11/20/62/54732040-bf13-412e-8d47-09b1736264d6

Gjatë vitit 2025, u ndërmorën disa nisma ligjore të lidhura me Grupkapitullin e Parë "Themeloret" dhe me forcimin e transparencës, integritetit dhe luftës kundër korrupsionit. Ndër to, tre kanë rëndësi të veçantë për veprimtarinë e OJF-ve: projektligji "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", projektligji "Për lobimin" dhe projektligji "Për donacionet dhe sponsorizimet". Ndonëse këto nisma synonin forcimin e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies, gjatë proceseve të konsultimit, OJF-të ngritën shqetësime lidhur me dispozita të caktuara dhe ndikimin e mundshëm të tyre mbi veprimtarinë e organizatave.

Projektligji "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" synonte forcimin e kuadrit ligjor për sinjalizimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Gjatë procesit të konsultimit, Partnerët Shqipëri ngriti disa shqetësime lidhur me qartësinë dhe zbatimin efektiv të kuadrit të propozuar. Këto përfshinin mungesën e shfuqizimit të shprehur të ligjit nr. 60/2016, që mund të krijonte pasiguri ligjore dhe mbivendosje të dispozitave; mungesën e dispozitave kalimtare për strukturat ekzistuese të sinjalizimit; garancitë e pamjaftueshme për pavarësinë funksionale dhe buxhetore të ILDKPKI-së; si dhe nevojën për një bashkërendim më të qartë me institucionet e tjera ligjzbatuese.[15] Rekomandimet synonin forcimin e qartësisë ligjore, pavarësisë institucionale dhe bashkërendimit, për të mundësuar zbatimin e njëtrajtshëm dhe efektiv të këtij kuadri.

Projektligji "Për lobimin" synonte të rriste transparencën dhe llogaridhënien në proceset e ndikimit mbi vendimmarrjen publike. Duke mbështetur synimin për më shumë transparencë, OJF-të ngritën shqetësime lidhur me përkufizimin e gjerë dhe fushën e zbatimit të veprimtarive të lobimit, veçanërisht me rrezikun që advokimi i OJF-ve në interes të publikut të trajtohej njëlloj si lobimi profesional apo tregtar në shërbim të interesave private.[16] Gjithashtu, u ngritën shqetësime mbi proporcionalitetin e kërkesave për regjistrim dhe raportim për OJF-të, veçanërisht për organizatat e vogla me kapacitete të kufizuara administrative. Rekomandimet theksonin nevojën për të dalluar qartë advokimin e shoqërisë civile nga lobimi profesional dhe për të siguruar që kërkesat për transparencë të mos krijonin pengesa joproporcionale për pjesëmarrjen e OJF-ve në proceset e politikëbërjes. Projektligji "Për donacionet dhe sponsorizimet", i cili është pjesë e këtyre reformave dhe ka rëndësi të veçantë për aksesin e OJF-ve në burime, analizohet në detaje në fushën 2.1.

Kuadri ligjor u lejon organizatave të krijojnë rrjete brenda dhe jashtë vendit, pa njoftim paraprak. Nëse zgjedhin të regjistrohen, rrjetet duhet të marrin një nga format ligjore të parashikuara në ligj: qendër, shoqatë ose fondacion. Nuk ka dispozita ligjore që parashikojnë bllokimin e rrjeteve sociale.

Praktika është në përputhje me kuadrin ligjor, duke garantuar mundësinë e personave fizikë dhe juridikë për të themeluar organizata jofitimprurëse. Megjithatë, respektimi i afateve të regjistrimit dhe përballimi i kostove mbetën sfida të pazgjidhura plotësisht. Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (në vijim: Gjykata), në vitin 2025 rezultonin të regjistruara gjithsej 13,300 OJF, rreth 2% më shumë krahasuar me vitin 2024. Gjatë vitit 2025 u regjistruan gjithsej 246 OJF të reja, prej të cilave 140 shoqata, 65 qendra dhe 41 fondacione. Lidhur me kërkesat për regjistrim, Gjykata mori 65 vendime për rrëzimin e kërkesave që në fazën fillestare, për shkak të mosplotësimit të kërkesave ligjore apo dokumentacionit të paplotë. Gjithashtu, mori 40 vendime për pushimin e procedimit dhe kthimin e dosjeve, në rastet kur të njëjtat mangësi u konstatuan pas fillimit të procedimit. Gjykata nuk vuri në dispozicion të dhëna mbi rastet e refuzimit të së drejtës së individëve për të qenë anëtarë themelues të OJF-ve. Sipas Gjykatës, identifikimi i këtyre rasteve

[15] Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. (2025). *Komente mbi projektligjin "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"*. I disponueshëm: https://www.partnersalbania.org/News/comments-on-the-draft-law-on-whistleblowing-and-whistleblower-protection/
[16] Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. (2025). *Komente dhe rekomandime mbi projektligjin "Për lobimin"*. I disponueshëm: https://www.partnersalbania.org/News/comments-and-recommendations-on-the-draft-law-on-lobbying/

do të kërkonte shqyrtimin individual të çdo vendimi, proces që nuk mund të realizohej për shkak të kapaciteteve të kufizuara njerëzore. Sipas INSTAT-it, në fund të vitit 2025 kishte 2,412 OJF dhe organizata ndërkombëtare aktive, kundrejt 2,494 në vitin 2024, duke shënuar një rënie prej afërsisht 3,3%. Prej tyre, 178 ishin regjistruar gjatë vitit 2025.[17]

Në praktikë, regjistri elektronik i OJF-ve, i cili duhej të bëhej funksional më 30 dhjetor 2023, vijon të mos jetë funksional. Më 26 shkurt 2026, Gjykata publikoi në faqen e saj të internetit një listë të OJF-ve. [18] Megjithatë, në formën e disponueshme, kjo listë nuk përmbushte funksionet e një regjistri elektronik plotësisht funksional. Ajo dukej e paplotë dhe mbetej e paqartë se në ç'masë i përfshinte të gjitha organizatat dhe sa të besueshme ishin të dhënat e saj. Gjithashtu, informacioni i ofruar ishte i pakët dhe ndërfaqja nuk u mundësonte përdoruesve kërkimin, filtrimin apo renditjen efektive të të dhënave, duke kufizuar aksesin në informacion.
Në maj 2025, Partnerët Shqipëri zhvilloi një anketim me 76 OJF, të përqendruar vetëm në procedurat e regjistrimit dhe ri regjistrimit. Anketimi u plotësua me intervista me përfaqësues të OJF-ve, për të shqyrtuar më në thellësi përvojat e tyre. Gjetjet evidentuan vështirësi të konsiderueshme dhe të vazhdueshme, me 80% të OJF-ve të anketuara që raportuan probleme me këto procedura. Organizatat i përshkruan përgjithësisht procedurat gjyqësore për regjistrimin e ndryshimeve të gjata, paqarta dhe me ngarkesë të lartë administrative.

Shqetësimi më i shpeshtë i raportuar lidhej me vonesat e tejzgjatura në shqyrtimin e kërkesave, të cilat në shumë raste zgjatnin nga disa muaj e deri në një apo dy vjet, e në raste të caktuara edhe më shumë. Këto vonesa preknin regjistrimin e ndryshimeve në statut, të adresës, përfaqësuesve ligjorë dhe rinovimin e mandateve të anëtarëve të organit drejtues. Si anketimi, ashtu edhe intervistat evidentuan mungesën e parashikueshmërisë dhe të praktikave të njëtrajtshme në trajtimin e çështjeve si një problematikë të rëndësishme. Organizatat raportuan se çështje të ngjashme ishin trajtuar në mënyra të ndryshme nga gjyqtarë të ndryshëm, duke përfshirë refuzime të përsëritura dhe kërkesa për dokumentacion shtesë, të cilat jo gjithmonë perceptoheshin si të mbështetura qartë në dispozitat ligjore. Gjetjet evidentuan gjithashtu mungesën e udhëzimeve të mjaftueshme nga Gjykata dhe mangësitë në komunikimin me të. Organizatat theksuan vështirësitë në marrjen e informacionit mbi ecurinë e kërkesave, kontaktimin e stafit të Gjykatës dhe kuptimin e kërkesave procedurale. Në disa raste, edhe marrja e një konfirmimi të thjeshtë për dorëzimin e kërkesës kërkonte disa paraqitje pranë Gjykatë, Këto mangësi procedurale çuan në bllokimin e llogarive bankare, vështirësi në përditësimin e të dhënave pranë institucioneve publike dhe vonesa në nënshkrimin e marrëveshjeve të granteve dhe zbatimin e projekteve. Përqendrimi i procedurave në Tiranë krijoi ngarkesë shtesë për OJF-të jashtë kryeqytetit. Në vitin 2025, regjistrimi pranë Gjykatës zgjati mesatarisht 90 ditë.[19]

"Jemi një organizatë e sapo themeluar që vepron në rajonin e Dibrës. Pas ndryshimit të ambienteve të zyrës, i paraqitëm Gjykatës kërkesën për ndryshimeve përkatëse. Megjithatë, miratimi i tyre zgjati katër muaj. Na u desh të udhëtonim disa herë drejt Tiranës, gjë që kërkoi kohë dhe shpenzime shtesë"

Drejtor Ekzekutiv i një organizate Rinore nga rajoni i Dibrës

[17] INSTAT, 2026 "Regjistrat e Biznesit". I disponueshëm: https://www.instat.gov.al/media/2hololz3/tab-1-nj%C3%ABsi-ligjore-aktive-sipas-form%C3%ABs-ligjore.xlsx
[18] Informacioni është i disponueshëm në faqen e internetit të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. I disponueshëm: Regjistri elektronik OJF
[19] Informacioni u mor nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në përgjigje të një kërkese për informacion të paraqitur nga Partnerët Shqipëri.

1.1.2. Ndërhyrja e Shtetit

Kuadri ligjor garanton autonominë e OJF-ve. Organizatat janë të lira të përcaktojnë strukturën dhe procedurat e tyre të brendshme, pa pjesëmarrje të shtetit në organet drejtuese apo ndërhyrje shtetërore në emërimin e anëtarëve në këto organe. Për ushtrimin e veprimtarisë së tyre nuk kërkohet miratim paraprak nga shteti. Kur kërkohet licencim për fusha të caktuara të veprimtarisë, si shërbimet sociale dhe shëndetësore apo arsimi profesional, kjo kërkesë parashikohet shprehimisht në ligj.[20] Kuadri ligjor parashikon gjithashtu mekanizma të përgjithshëm për mbrojtjen e lirisë së organizimit, përfshirë garancitë kushtetuese,[21] mjetet e mbrojtjes gjyqësore, mbrojtjen nga Policia,[22] dhe garancitë kundër diskriminimit.[23] Ndonëse këto garanci nuk parashikohen posaçërisht për OJF-të, ato përbëjnë bazën ligjore për mbrojtjen dhe ushtrimin e lirisë së organizimit.

Për sa i përket raportimit financiar, kuadri rregullator merr parasysh karakteristikat e OJF-ve dhe përshtatet me të ardhurat e tyre. Sipas rregullave të kontabilitetit për OJF-të, aktivet ose të ardhurat e të cilave nuk tejkalojnë vlerën e 5 milionë Lekë (rreth 52,000 Euro), zbatojnë kontabilitetin mbi bazën monetare dhe përgatisin vetëm pasqyrën e flukseve monetare, të shoqëruar me shënime shpjeguese mbi natyrën e veprimtarive ose shërbimeve të tyre. OJF-të, aktivet ose të ardhurat e të cilave tejkalojnë këtë prag, zbatojnë kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe përgatisin një grup të plotë pasqyrash financiare.[24]

Në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit (PPP/LFT), në tetor 2025, Ministria e Financave shpalli për konsultim publik projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, 'Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit', të ndryshuar".[25] Ky projektligj prezantoi formulimin *"organizatat jofitimprurëse të konsideruara me rrezik të lartë"*. Ky formulim nuk është në përputhje me Rekomandimin 8 të FATF-së dhe ngre disa shqetësime. Specifikisht, ai nuk përcakton qartë se kush e vendos këtë klasifikim apo mbi çfarë baze, lë hapësirë për interpretim subjektiv nga autoritetet dhe mbart një ngarkesë negative që mund të dëmtojë reputacionin e organizatave të përfshira në këtë kategori. Këto shqetësime u ngritën gjatë procesit të konsultimit, por rekomandimet nuk u morën parasysh, me arsyetimin se formulimi ligjor i propozuar u ruajt për të siguruar përputhjen me standardet e FATF-së dhe parimin e proporcionalitetit, ndërsa kriteret e hollësishme, procedurat dhe përgjegjësitë institucionale u lanë për t'u rregulluar përmes akteve nënligjore dhe metodologjisë së Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut.[26]

Gjatë vitit 2025 nuk pati ndryshime ligjore për pronarin përfitues dhe dispozitat e miratuara me ligjin nr. 6/2022, parashikojnë sanksione administrative nga 50,000 Lekë (rreth 520 Euro) deri në 600,000 Lekë (rreth 6,250

[20] Ligji Nr. 8788, date 7.5.2001, "Për organizatat jofitimprurëse", Neni 6, 7, 20, dhe 34; I disponueshëm: https://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/05/07/8788
[21] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 46. I disponueshëm: https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd
[22] Republika e Shqipërisë (2024). Ligji. Nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit". I disponueshëm: https://asp.gov.al/wp-content/uploads/2025/08/Law-no.82-for-State-Police-26.7.2024-English.pdf
[23] Ligji Nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" I disponueshëm: https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/04/Law-on-Protection-from-Discrimination-Albania.-2020.pdf
[24] Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, (2018), "*Standardet Kombëtare të Kontabilitetit për OJF-të*". I disponueshëm: https://kkk.gov.al/udhezuesi-per-hartimin-e-raportit-jofinanciar/
[25] Informacioni është marrë nga platforma qeveritare e konsultimit publik. I disponueshëm: https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/888
[26] Informacioni është marrë nga platforma qeveritare e konsultimit publik. I disponueshëm: https://www.konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_888_Raporti-individual--i-Konsultimit-Publik.docx

Euro).[27] Sipas Raportit Vjetor 2025 të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), autoriteti përgjegjës për administrimin e Regjistrit të Pronarëve Përfitues, gjatë vitit 2025, aplikuan gjithsej 366 OJF për regjistrimin e pronarëve të tyre përfitues.[28] Megjithatë, raporti nuk jep informacion mbi numrin e aplikimeve të miratuara. Ai evidenton gjithashtu vendosjen e gjobave ndaj subjekteve tregtare dhe OJF-ve që nuk kishin përmbushur detyrimin për regjistrimin fillestar ose përditësimin e të dhënave të pronarëve përfitues brenda afateve ligjore. Po ashtu, gjatë vitit 2025, QKB u dërgoi subjekteve raportuese 23 njoftime për mospërputhje në të dhënat e Regjistrit të Pronarëve Përfitues, bazuar në informacionin e përcjellë nga bankat e nivelit të dytë. Të dhënat nuk janë të ndara sipas kategorisë së subjektit, ndaj nuk mund të përcaktohet se sa prej këtyre rasteve u përkisnin OJF-ve dhe sa subjekteve tregtare. Për të siguruar informacion më të detajuar, Partnerët Shqipëri i drejtoi QKB-së një kërkesë për informacion, por nuk mori përgjigje.

Ligji "Për organizatat jofitimprurëse" (Kreu VIII) dhe ligji "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse" (Seksioni V, Kreu II) përcaktojnë dispozitat kryesore ligjore për shpërndarjen, likuidimin dhe çregjistrimin e OJF-ve. Shpërndarja mund të bëhet vullnetarisht ose me vendim gjykate në rastet e veprimtarisë së kundërligjshme, shkeljes së Kushtetutës, themelimit në kundërshtim me ligjin ose falimentimit. Përveç rasteve të rënda, gjykata duhet së pari t'i japë organizatës mundësinë të korrigjojë shkeljen. Çregjistrimi kryhet nëpërmjet regjistrit elektronik, në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, duke sjellë humbjen e personalitetit juridik. Të dhënat e organizatave të çregjistruara mbeten të aksesueshme për publikun në regjistër, me shënimin "çregjistruar", ndërsa emri i organizatës nuk mund të ripërdoret për gjashtë muaj.

Sa i përket zbatimit në praktikë, si Avokati i Popullit ashtu edhe Policia e Shtetit raportuan mungesë të ankesave zyrtare për kërcënime nga zyrtarët, ndërhyrje në vetëqeverisjen e organizatave ose kontrolle arbitrare e të paparalajmëruara.[29] Ndërkohë, monitorimi i kryer për përgatitjen e këtij raporti identifikoi një numër të kufizuar rastesh, përfshirë një rast të raportuar nga KRIIK. Më 13 mars 2025, Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) shprehu publikisht shqetësimin për presionin ndaj institucioneve të pavarura dhe shoqërisë civile në prag të zgjedhjeve, ku kritikoi interpretimet e ngushta të keqpërdorimit të burimeve publike, paralajmëroi për rreziqet ndaj pavarësisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i cilësoi deklaratat e një deputeti në detyrë si frikësuese ndaj organizatave që monitorojnë zgjedhjet.[30]

Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) raportoi se gjatë vitit nuk ka marrë raporte të aktivitetit të dyshimtë që lidhnin OJF-të me dyshime për financim të terrorizmit, nuk pati kufizime në aksesin e OJF-ve ndaj financimit të huaja përmes institucioneve bankare ose jobankare dhe nuk u lëshuan urdhra për ngrirjen e përkohshme të llogarive apo transaksioneve të OJF-ve.[31] As OJF-të e intervistuara nuk raportuan sanksione. Megjithëse nuk u raportuan raste të lidhura me PPP/LFT, një organizatë raportoi vështirësi gjatë procesit të regjistrimit të pronarëve përfitues, të cilat rrezikuan veprimtarinë e saj dhe aksesin në financim. Problemi lindi pasi drejtoria rajonale tatimore kishte lëshuar certifikatën e NIPT-it me vulë elektronike, të cilën QKB-ja nuk e njohu. Vonesa në këtë proces pengoi hapjen e llogarisë bankare brenda afatit të nevojshëm dhe, për rrjedhojë, rrezikoi

[27] Fletorja Zyrtare nr. 149/2022, ligji nr. 6/2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 112/2020 'Për regjistrin e pronarëve përfitues', të ndryshuar". I disponueshëm: https://qbz.gov.al/preview/caaa4106-aab1-44bb-a34b-1ada78851423/cons/20220216

[28] Qendra Kombëtare e Biznesit (2026) *"Raporti Vjetor 2025"*. I disponueshëm: https://qkb.gov.al/wp-content/uploads/2026/03/Raport-Vjetor-2025.pdf

[29] Informacioni është marrë nga Avokati i Popullit dhe Policia e Shteti përmes kërkesës për informacion të Parterëve Shqipëri.

[30] KRIIK, *"Deklarata frikësuese ndaj KRIIK dhe KQZ-së nga Kryetari i Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare: shqetësim në rritje për qëndrimin e shumicës socialiste ndaj zërit të pavarur dhe kritik të shoqërisë civile dhe institucioneve të pavarura"*, 2025. I disponueshëm: https://kriik.al/home/en/2025/03/13/intimidating-statements-against-kriik-and-the-cec-by-the-chairman-of-the-parliamentary-national-security-committee-a-growing-concern-over-the-socialist-majoritys-attitude-towards-the-indepen/

[31] Informacioni është marrë nga Agjencia e Inteligjencës Artificiale përmes kërkesës për informacion nga Partnerët Shqipëri.

mundësinë e organizatës për të përfituar grantin. Pas një muaji takimesh dhe negociatash me të dy institucionet, QKB-ja përfundoi regjistrimin e pronarëve përfitues të organizatës.

Sa i përket shpërbërjes, Gjykata, në përgjigje të një kërkese të paraqitur nga Partnerët Shqipëri, bëri të ditur se aktualisht 28 organizata janë në proces likuidimi ose janë çregjistruar. Por, ajo nuk dha informacion mbi arsyet që çuan në këto vendime.

1.1.3. Aksesi në Burimet Financiare

Kuadri ligjor u lejon OJF-ve të kërkojnë dhe të sigurojnë burime financiare vendase dhe të huaja për të mbështetur veprimtarinë e tyre, përfshirë grantet, dhurimet dhe burime të tjera. Gjithashtu, si fondacionet, ashtu edhe shoqatat lejohen të kryejnë investime pasive,[32] duke u mundësuar atyre të "zotërojnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe të sigurojnë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive".[33]

Përveç këtyre burimeve të financimit, kuadri ligjor u lejon OJF-ve të ushtrojnë edhe veprimtari ekonomike për të gjeneruar të ardhura në mbështetje të përmbushjes së qëllimeve të tyre. Kjo veprimtari mund të zhvillohet në kuadër të organizatës ekzistuese, pa pasur nevojë për krijimin dhe regjistrimin e një personi juridik të veçantë.[34] Ajo duhet: (i) të jetë në përputhje me qëllimin dhe objektivat e OJF-së; (ii) të deklarohet si një nga burimet e saj të të ardhurave; dhe (iii) të mos përbëjë veprimtarinë kryesore ose qëllimin parësor për të cilin është themeluar. Sipas Vendimit nr. 953, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë'", të ndryshuar, të ardhurat nga veprimtaria ekonomike, si veprimtari dytësore e organizatës, nuk duhet të tejkalojnë 20% të të ardhurave të saj të përgjithshme vjetore. Gjithashtu, Shqipëria ka një kuadër ligjor të posaçëm për ndërmarrjet sociale. Megjithatë, siç është evidentuar në raportet e mëparshme të Matricës së Monitorimit (MM), ky kuadër përmban përkufizime të paqarta dhe procedura të ndërlikuara, duke krijuar paqartësi lidhur me marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale dhe aksesin në mbështetje financiare.

Në praktikë, OJF-të ushtruan veprimtari ekonomike. Sipas përgjigjes së marrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, 13 organizata kishin përfituar statusin e "ndërmarrjes sociale". Gjatë periudhës 2024–2025, tre prej tyre përfituan mbështetje financiare nga fondi për ndërmarrjet sociale, në një shumë të përgjithshme prej 13,450,000 Lekësh (rreth 140,000 Euro). Megjithatë, aksesi në financim mbetet sfida kryesore për OJF-të që ushtrojnë veprimtari si ndërmarrje sociale, krahas mungesës së stimujve fiskalë dhe një kuadri ligjor kufizues. Ky kuadër karakterizohet nga kritere të paqarta dhe procedura të rënduara për marrjen dhe ruajtjen e statusit të ndërmarrjes sociale, pragje të detyrueshme për punësimin dhe të ardhurat, kufizime në përcaktimin e pagave, kërkesa për auditim të jashtëm vjetor dhe një qasje e orientuar drejt sanksioneve. Të gjithë këta faktorë cenojnë qëndrueshmërinë, pavarësinë dhe potencialin e tyre për zhvillim të mëtejshëm.

Intervistat dhe diskutimet në fokus grupe nuk evidentuan raste të kufizimit nga ana e shtetit të aksesit të OJF-ve në financime nga burime të huaja. Pjesëmarrësit raportuan në mënyrë të njëtrajtshme se donatorët e huaj, veçanërisht Bashkimi Evropian, mbeten burimi kryesor i mbështetjes financiare. Ata theksuan se sfidat praktike lidheshin me zbatimin e procedurave të përjashtimit të TVSH-së. Ata vunë në dukje se autoritetet publike duhej

[32] Investimet pasive përfshijnë interesat, dividendët, fitimet kapitale dhe të ardhura të tjera nga investimi i pasurive të organizatës.
[33] Nenet 39/1 dhe 56/1 të Kodit Civil, përkatësisht për shoqatat dhe fondacionet.
[34] Ligji nr. 8788, datë 7.5.2001, "Për organizatat jofitimprurëse". I disponueshëm: https://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/05/07/8788

t'u ofronin si OJF-ve, ashtu edhe subjekteve private, udhëzime më të qarta dhe më të plota mbi kërkesat dhe procedurat përkatëse.

Sa i përket aksesit në financimin privat, intervistat me OJF-të treguan se marrja e mbështetjes financiare nga individë dhe kompani nuk shoqërohet, në përgjithësi, me pengesa administrative. Ato gjithashtu vunë në dukje se dhurimet individuale përmes platformës Smile.al ishin një burim i rëndësishëm financimi, veçanërisht për organizatat e reja. Gjatë vitit 2025, përmes dhurimeve të kryera në këtë platformë, përfituan mbështetje financiare 14 organizata.

OJF-të duhet të hapin një llogari bankare brenda 20 ditëve kalendarike nga regjistrimi në organet tatimore dhe ta deklarojnë atë pranë këtyre organeve. Në praktikë, procedurat e bankave për PPP kërkojnë dokumente identifikimi për të gjithë anëtarët e organeve drejtuese, megjithëse kjo nuk kërkohet shprehimisht në ligj. Kjo krijonte barrë administrative, veçanërisht kur anëtarët banonin jashtë vendit, duke nxjerrë në pah nevojën për qartësi më të madhe rregullatore.

Aksesi në kredi bankare nuk është ende një mundësi financimi për OJF-të. Nga informacioni i disponueshëm publikisht dhe rastet e dokumentuara të identifikuara gjatë monitorimit, nuk rezultoi që OJF-të të kishin përfituar kredi bankare gjatë vitit 2025. Gjithashtu, nga shqyrtimi i produkteve të ofruara nga bankat tregtare dhe institucionet financiare jobankare nuk u evidentua produkte kredie të përshtatura posaçërisht për nevojat e sektorit jofitimprurës.

1.2. Liritë e tjera

1.2.1. Liria për Tubime Paqësore

Gjatë vitit 2025, legjislacioni që rregullon të drejtën e tubimit paqësor nuk pësoi ndryshime. Sikurse është theksuar edhe në raportet e mëparshme të MM-së, ky kuadër ligjor përputhet në masë të madhe me standardet ndërkombëtare dhe siguron ushtrimin e barabartë të kësaj të drejte për të gjithë qytetarët. Neni 47 i Kushtetutës garanton të drejtën për tubim paqësor dhe pa armë, ndërsa ligji nr. 8773/2001, "Për tubimet", përcakton rregullat për ushtrimin e saj.

Ky kuadër ligjor parashikon detyrimin për njoftim paraprak të tubimeve publike, mundësinë e organizimit të tubimeve urgjente në rrethana të jashtëzakonshme, si dhe përcakton qartë rastet e kufizimit të kësaj lirie. Njëkohësisht, ai u ngarkon autoriteteve publike detyrime pozitive për të lehtësuar dhe mbrojtur zhvillimin e tubimeve. Pavarësisht këtyre garancive, legjislacioni vijon të mos përmbajë dispozita të posaçme për rregullimin e kundërtubimeve.

Po ashtu, ligji nuk parashikon kufizime të përgjithshme mbi organizimin e tubimeve dhe njeh të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj vendimeve kufizuese. Megjithatë, hapat për paraqitjen dhe shqyrtimin e këtyre ankimeve mbeten të paqarta, pasi ligji nuk përmban referenca të mjaftueshme ndaj akteve të tjera ligjore që rregullojnë këtë procedurë.

Në praktikë, liria e tubimit paqësor u respektua përgjithësisht gjatë vitit 2025. Sipas të dhënave zyrtare të Policisë së Shtetit, OJF-të paraqitën gjithsej 22 njoftime për organizimin e tubimeve publike. Gjatë kësaj periudhe nuk u evidentuan protesta pa njoftim paraprak dhe as kërkesa për tubime urgjente.

Këto tubime u fokusuan në një sërë çështjesh me interes publik. Temat kryesore përfshinë të drejtat e fëmijëve, luftën kundër homofobisë, mbrojtjen e mjedisit, të lumit Vjosa dhe të hapësirave publike të plazheve, si dhe cilësinë e shërbimeve publike dhe sigurinë rrugore. Gjithashtu, u organizuan protesta kundër ligjit për barazinë gjinore dhe marrëveshjes Shqipëri–Itali për strehimin e migrantëve.

Policia e Shtetit bëri të ditur se nuk refuzoi asnjë njoftim të paraqitur nga OJF-të dhe nuk konstatoi akte dhune nga organizatorët apo pjesëmarrësit. Nga ana tjetër, Avokati i Popullit konfirmoi se gjatë vitit 2025 nuk u regjistrua asnjë ankesë nga OJF-të, grupet informale, aktivistët apo mediat lidhur me organizimin dhe pjesëmarrjen në tubime. Po ashtu, të dhënat e disponueshme nuk tregojnë raste të pengimit të gazetarëve apo vëzhguesve gjatë mbulimit të këtyre ngjarjeve.

1.2.2. Liria e Shprehjes

Kuadri ligjor garanton lirinë e shprehjes dhe aksesin në informacion në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kushtetuta e Shqipërisë garanton lirinë e shprehjes dhe të drejtën për të kërkuar, marrë dhe përhapur informacion, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Sipas Nenit 17 të saj, kufizimi i këtyre lirive lejohet vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Çdo kufizim i tillë duhet të jetë proporcional me qëllimin që synon të arrijë dhe nuk mund të tejkalojë kufijtë e përcaktuar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në zbatim të këtyre parimeve, kuadri ligjor vendas rregullon raste të veçanta të kufizimit të lirisë së shprehjes, si ato që lidhen me gjuhën e urrejtjes dhe luftën kundër dezinformimit, të cilat përgjithësisht janë në linjë me standardet ndërkombëtare.[35]

Gjuha e urrejtjes adresohet përmes dispozitave të Kodit Penal.[36] Gjithashtu, legjislacioni për mediat audiovizive, i mbikëqyryr nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), u kërkon ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizive të raportojnë lajmet me vërtetësi dhe objektivitet. Kodi i Transmetimit për Mediat Audiovizive, i miratuar në vitin 2023, ndalon transmetimin e përmbajtjeve me gjuhë urrejtjeje dhe e përkufizon këtë të fundit në terma të gjerë në linjë me standardet evropiane. Ndërkohë, Shqipëria nuk ka një kuadër të vetëm ligjor të posaçëm për trajtimin e dezinformimit. Masat në këtë fushë mbështeten në një ndërthurje të rregullave për median, legjislacionit zgjedhor dhe mekanizmave institucionalë e të vetërregullimit.

Gjatë vitit 2025, pati zhvillime të rëndësishme lidhur me ndryshimet në Kodin Penal. Në korrik 2025, Ministria e Drejtësisë publikoi për konsultim një projektligj të ri të Kodit Penal, i cili ngriti shqetësime tek OJF-të. Ndryshimet e propozuara parashikonin ashpërsimin e dënimeve, hiqnin kushtin që informacioni i rremë të ishte përhapur me vetëdije dhe nuk përfshinin dekriminalizimin e plotë të shpifjes, duke rënë ndesh me angazhimet e procesit të integrimit në BE. Në dhjetor 2025, u hodh për konsultim një nismë tjetër për heqjen e dispozitave të Kodit Penal që parashikojnë dënime penale për shpifjen. Megjithatë, në janar 2026, Kuvendi miratoi një

[35] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. I disponueshëm: https://klgj.al/media/hvdbnqvu/law-no-76-2016-constitution-of-the-republic-of-albania-as-amended-revised-2021.pdf
[36] Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 265 dhe 266. I disponueshëm: https://qbz.gov.al/eli/ligj/1995/01/27/7895

paketë të rishikuar ndryshimesh, e cila nuk garantoi dekriminalizimin e plotë të saj. Mbrojtja ligjore mbeti e kufizuar te gazetarët “e regjistruar” ose “të njohur”, duke përjashtuar publikun e gjerë, aktivistët dhe OJF-të.

Në praktikë, sipas Reporterëve pa Kufij, Shqipëria përmirësoi pozicionin e saj në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit, duke u ngjitur në vendin e 80-të në vitin 2025, krahasuar me vendin e 99-të që mbante në vitin 2024.[37] Po ashtu, nuk u identifikuan raste të dokumentuara publikisht të përfaqësuesve të OJF-ve që të jenë sanksionuar apo përndjekur për shkak të shprehjes së mendimeve kritike. Megjithatë, intervistat me ekspertë treguan se paditë për shpifje vazhdojnë të ngrihen në gjykata, ndonëse mungojnë të dhënat e sakta nëse këto raste prekin OJF, media apo individë të tjerë.

Në të njëjtën kohë, Raporti i Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut për Shqipërinë dokumenton përdorimin e padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) ndaj aktivistëve mjedisorë dhe të komunitetit.[38] Një kompani hidroenergjie ngriti padi për shpifje dhe fyerje kundër tre aktivistëve nga Mirdita pasi ata denoncuan publikisht dëmin mjedisor të shkaktuar nga hidrocentralet në një zonë të mbrojtur. Ekspertët ligjorë e e cilësuan rastin si një padi tipike SLAPP, duke vënë në dukje bazën e dobët faktike të pretendimeve dhe dëmshpërblimet joproporcionale të kërkuara, të cilat varionin nga 50,000 Lekë deri në 3,000,000 Lekë (afërsisht 524 deri në 31,440 euro). Padia u perceptua gjerësisht si një përpjekje për të heshtur zërat kritikë dhe për të frenuar pjesëmarrjen publike, duke i ekspozuar aktivistët ndaj proceseve të zgjatura gjyqësore dhe kostove të larta ligjore. Edhe pse kompania u tërhoq nga procesi në janar 2026 duke mos u paraqitur në gjykatë, raporti vëren se aktivistët vijuan të përballeshin me presione përmes fushatave të koordinuara të denigrimit në internet dhe përmbajtjes të sponsorizuara në rrjetet social,e të cilat shënjestronin si aktivistët, ashtu edhe median e pavarur.

1.2.3. Hapësirë Qytetare e Hapur, e Sigurtë dhe e Mbrojtur

Korniza ligjore mbron të drejtën për të komunikuar, për të aksesuar informacion dhe për të ushtruar lirinë e shprehjes online duke qenë përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Këto garanci janë të sanksionuara në Kushtetutën e Shqipërisë, e cila mbron lirinë e shprehjes, të drejtën për informacion dhe mbrojtjen e të dhënave personale, parime që shtrihen edhe në sferën digjitale. [39] Nuk janë identifikuar pengesa ligjore që kufizojnë në mënyrë specifike aksesin e OJF-ve në informacion. Garancitë kundër monitorimit të pajustifikuar të komunikimeve përcaktohen përmes Kodit të Procedurës Penale, i cili e lejon atë vetëm me vendim gjykate në kuadër të hetimeve penale. Këto masa plotësohen nga Ligji për Komunikimet Elektronike,[40]që siguron konfidencialitetin dhe sigurinë e komunikimeve, si dhe nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, [41] i cili përcakton rregullat e përgjithshme për mbrojtjen dhe përpunimin e tyre.

Sa u përket masave mbrojtëse kundër kërcënimeve, ngacmimeve dhe sulmeve, kuadri ligjor ofron mekanizma të përgjithshëm për raportimin e incidenteve, kërkimin e mbrojtjes dhe qasjen në mjete juridike. Këto

[37] Reporterë pa Kufij (2026), Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit 2025. I disponueshëm: https://rsf.org/en/country/albania
[38] Civil Rights Defenders, 2026, “Raporti për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Shqipëri 2025”. I disponueshëm: https://acgj.al/wp-content/uploads/2026/05/HRD-Albania-2025-updated.pdf
[39] Fletore Zyrtare Nr. 28/1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 21 tetor 1998, e ndryshuar. E disponueshme: https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd
[40] Fletore Zyrtare Nr. 96/2024, Ligji Nr. 54/2024, datë 30.5.2024, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”. E disponueshme: https://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/05/30/54
[41] Fletore Zyrtare 9/2025, Ligji Nr. 124/2024, datë 19.12.2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. E disponueshme: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/12/19/124

mekanizma janë në dispozicion të përfaqësuesve të OJF-ve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut, duke përfshirë kanalet e specializuara për raportimin e krimeve kibernetike. Në mënyrë specifike, OJF-të mund t'u drejtohen organeve ligjzbatuese dhe gjykatave, Avokatit të Popullit (për çështje që përfshijnë autoritetet publike), si dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (për raste që lidhen me aksesin në informacion ose përpunimin e të dhënave).

Në fushën e sigurisë digjitale, Ligji nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike" [42] përcakton një kuadër gjithëpërfshirës, duke vendosur kërkesa të qarta sigurie dhe detyrime për raportimin e incidenteve. Për të zbatuar dhe zgjeruar këto masa, në tetor 2025 Qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2025–2030 dhe Planin e Veprimit 2025–2027, [43] të cilat synojnë forcimin e infrastrukturës digjitale dhe përafrimin e mëtejshëm me standardet e BE-së dhe NATO-s.

Pavarësisht ekzistencës së mbrojtjeve ligjore, hulumtimet e deritanishme[44] dhe OJF-të e intervistuara ngrenë shqetësime në lidhje me zbatimin e tyre në praktikë. Në fokus të veçantë kanë qenë investimet e Qeverisë në teknologjitë e mbikëqyrjes, si nisma "Smart City",[45] që parashikon vendosjen e kamerave me aftësi të avancuara identifikimi. Edhe pse projekti promovohet si një hap për rritjen e sigurisë publike, OJF-të dhe ekspertët e të drejtave digjitale vënë në dyshim nëse mekanizmat aktualë ligjorë dhe institucionalë sigurojnë transparencë, mbikëqyrje dhe llogaridhënie të mjaftueshme për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave personale.[46]

Intervistat me OJF-të që veprojnë në fushën e të drejtave digjitale ngritën shqetësime lidhur me efektivitetin e mekanizmave mbikëqyrës dhe zbatimin e tyre në praktikë. Këto shqetësime u pasqyruan në disa zhvillime gjatë vitit 2025. Parada e Krenarisë LGBTIQ+, e mbajtur më 24 maj nën moton "Krah për Krah", nxiti komente të shumta homofobike dhe gjuhë urrejtjeje, ndonëse asnjë prej tyre nuk iu atribuua aktorëve shtetërorë. Një studim i Rrjetit Shqiptar për Fuqizimin e Grave zbuloi se, nga 22 mbrojtëse të të drejtave të njeriut të anketuara, gjysma (50%) kishin përjetuar ngacmime ose kërcënime, përfshirë abuzime online dhe fizikisht, madje dhe kërcënime me vdekje. Gjithashtu, më shumë se një e treta e tyre kishin qenë objekt i fushatave denigruese që i etiketonin ato si "kundër familjes", "agjente të huaja" apo "të financuara nga Sorosi". [47]

Narrativat armiqësore ndaj shoqërisë civile u bënë veçanërisht të dukshme pas ndërprerjes së financimit nga USAID-it. Disa aktorë politikë dhe mediatikë e shfrytëzuan pezullimin e ndihmës së huaj për të vënë në pikëpyetje legjitimitetin, pavarësinë dhe transparencën e OJF-ve të financuara nga burime të jashtme, duke i portretizuar ato si të nxitura nga jashtë ose të motivuara politikisht. Të përhapura gjerësisht në platformat online dhe pjesërisht nga media tradicionale, këto qasje dëmtuan reputacionit dhe rritën armiqësinë ndaj organizatave që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, të drejtave LGBTIQ+ dhe çështjeve të tjera me interes publik.

[42] Ligji Nr. 25/2024 "Për Sigurinë Kibernetike".I disponueshëm në: https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/ligj-2024-03-21-25-5-1.pdf
[43] Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030 dhe Plani i Veprimit 2025–2027. E disponueshme: https://aksk.gov.al/en/the-national-cyber-security-strategy-2025-2030-and-action-plan-are-approved
[44] Civil Rights Defenders, 2026, "Raporti për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Shqipëri 2025". I disponueshëm: Human Rights Defenders Report for Albania – 2025.
[45] Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë, "Smart City Albania", 19 12.2025. I disponueshëm: https://mb.gov.al/en/newsroom/smart-city-albania/
[46] Civil Rights Defenders, 2026, "Raporti për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Shqipëri 2025". I disponueshëm: Human Rights Defenders Report for Albania – 2025.
[47] Rrjeti për Fuqizimin e Grave në Shqipëri (AWEN), Gratë si Mbrojtëse të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri, 2025. I disponueshëm: https://awenetwork.org/media/682f2843bb7b1.pdf

Dinamika të ngjashme u shfaqën edhe gjatë konsultimeve mbi projektligjin për barazinë gjinore, kur grupet konservatore pretenduan se legjislacioni do të "shpikte" gjini të reja dhe do të legjitimonte martesat e personave të të njëjtit seks. Debatet televizive e nxitën më tej gjuhën e urrejtjes online kundër personave LGBTIQ+, aktivistëve dhe organizatave që mbështetën ligjin. Edhe raporti i BE-së për vitin 2025 konfirmoi se liria e shprehjes vijoi të përballet me kufizime në praktikë, përfshirë presionin politik, ndikimin ekonomik, paqartësinë institucionale dhe sulmet ose kërcënimet kundër gazetarëve. [48]

Sipas ekspertëve të intervistuar, pasqyrimi mediatik i protestave për çështjet gjinore e zhvendosi fokusin nga kërkesat thelbësore për barazi gjinore, tek pjesëmarrja e personave LGBTIQ+. Kjo qasje kontribuoi në një paraqitje të mangët të mesazhit dhe objektivave të këtyre tubimeve. Gjithashtu, organizatat LGBTIQ+ raportuan një rritje të reagimeve kundërshtuese, të nxitura nga media të caktuara, figura fetare dhe anëtarë të parlamentit, të cilët e paraqesin aktivizmin LGBTIQ+ si kërcënim për vlerat tradicionale. Personat transgjinorë janë veçanërisht të shënjestruar, ndërsa armiqësia publike që krijohet vështirëson punën e përditshme të këtyre organizatave dhe aftësinë e tyre për të zhvilluar tubime paqësore.

Gjatë vitit 2025, nuk u raportua në Policinë e Shtetit apo të Avokatit të Popullit incidente që përfshinin sulme ose ngacmime ndaj OJF-ve, përfaqësuesve të tyre apo aktivistëve. Po ashtu, asnjë organizatë nuk raportoi raste të monitorimit të pajustifikuar të kanaleve të saj të komunikimit apo të mbledhjes së paligjshme të të dhënave të përdoruesve.

[48] Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë 2025, SWD (2025) 750 final, që shoqëron Komunikatën e vitit 2025 mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së. I disponueshëm: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf

Fusha 2: **Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare të OJF-ve**

2.1. Trajtimi tatimor/ fiskal për OJF-të dhe donatorët e tyre

2.1.1. Përfitimet tatimore

Bazuar në legjislacionin në fuqi, të ardhurat nga burimet tradicionale jofitimprurëse të OJF-ve, siç janë dhurimet private ose korporative, grantet dhe kuotat e anëtarësimit, nuk i nënshtrohen Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Megjithatë, nëse një OJF ushtron aktivitet ekonomike për të gjeneruar të ardhura për financimin e aktiviteteve që lidhen me misionin e saj, ajo konsiderohet subjekt tatimpagues dhe duhet të regjistrohet në skemën e TVSH-së, pavarësisht qëllimit të aktivitetit. Përjashtohen nga TVSH-ja OJF-të që zhvillojnë aktivitete sociale, arsimore, kulturore ose sportive, të klasifikuara si aktivitete me interes të përgjithshëm (Neni 51, pikat e, f, i, j, k). Kjo përcaktohet më hollësisht në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 953, datë 29.12.2014 "Për zbatimin e dispozitave të Ligjit nr. 92/2014 'Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë'", të ndryshuar.[49] Mallrat dhe shërbimet duhet të ofrohen me çmime të miratuara nga autoritetet kompetente. Për të përfituar nga ky përjashtim, OJF-të duhet të plotësojnë njëkohësisht tri kritere: (i) organet drejtuese nuk duhet të kenë interes personal në veprimtarinë e fondacionit; (ii) veprimtaria jofitimprurëse duhet t'i paraprijë veprimtarisë ekonomike; dhe (iii) të ardhurat totale nga veprimtaria ekonomike, e cila konsiderohet si veprimtari dytësore e organizatës, nuk duhet të kalojnë 20% të të ardhurave totale vjetore. Procedura për përjashtimin nga TVSH-ja (Neni 3) kërkon dorëzimin pranë Zyrës Rajonale Tatimore të një sërë dokumentesh, si: vendimi gjyqësor i regjistrimit, statuti dhe akti i themelimit; një pasqyrë e të gjitha shërbimeve dhe mallrave të ofruara, së bashku me listën e çmimeve; deklarata e misionit dhe fushat kryesore programore; lista e grupeve përfituese; si dhe burimet financiare, përfshirë të ardhurat e pritshme nga veprimtaria ekonomike. Përjashtimi nga TVSH-ja është i vlefshëm për tre vjet, me mundësi rinovimi. Kur aplikohet për herë të parë, ky status është i vlefshëm për një vit.

Në vijim të udhëzimit të shkurtit të vitit 2025, është shënuar përparim në lëshimin zyrtar të certifikatave të përjashtimit nga TVSH-ja nga ana e SASPAC-ut për projektet e financuara nga donatorët. Dispozitat e reja përcaktojnë procedura më të qarta për zbatimin e përjashtimeve nga TVSH-ja në marrëveshjet e granteve, të cilat financohen përmes marrëveshjeve dypalëshe midis qeverisë shqiptare dhe qeverive të huaja, dhe që janë ratifikuar nga Parlamenti. Ky përjashtim tashmë është funksional dhe përbën një hap të rëndësishëm drejt lehtësimit të barrës financiare për OJF-të, duke adresuar një shqetësim të hershëm të ngritur nga organizatat e shoqërisë civile.

Interesi bankar i nënshtrohet tatimit në burim në masën 15%. Megjithatë, të ardhurat e përfituara nga OJF-të që plotësojnë kushtet për përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave, në përputhje me nenin 27 të Ligjit nr. 29/2023, nuk i nënshtrohen tatimit në burim.

[49] Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 953, datë 29.12.2014 “Për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 92/2014”, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. I disponueshëm: https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=13683

Gjithashtu, asnjë nga OJF-të e përfshira në këtë raport nuk raportoi raste të tatimit të fshehtë mbi grantet. Intervistat me që ushtronin veprimtari në fushën e sipërmarrjes sociale evidentuan një përdorim të kufizuar të lehtësive tatimore për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike. Kjo lidhej me fushën e ngushtë të zbatimit të dispozitave përkatëse, mungesën e qartësisë për zbatimin e tyre në praktikë, si dhe kërkesat administrative dhe detyrimet për përmbushjen e detyrimeve tatimore.

Gjithashtu, asnjë nga organizatat e konsultuara nuk raportoi të ardhura nga investimet pasive. Ndërkohë, nuk u identifikuan të dhëna të disponueshme publikisht mbi numrin e OJF-ve që gjeneronin të ardhura të tilla. Gjithashtu, administrata tatimore nuk e vuri në dispozicion këtë informacion në përgjigje të kërkesës së Partnerëve Shqipëri.

Ndonëse përjashtimi nga TVSH-ja përbën një hap të rëndësishëm drejt uljes së barrës financiare për OJF-të dhe thjeshtimit të procedurave përkatëse, efektiviteti i tij mbetet i kushtëzuar nga zbatimi i duhur nga institucionet përgjegjëse dhe ofruesit privatë të shërbimeve, si dhe nga rritja e ndërgjegjësimit të të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e granteve dhe në çështjet tatimore. Në lidhje me numrin e Certifikatave të Regjistrimit të Projekteve të lëshuara për OJF-të, SASPAC bëri të ditur se nuk mund të ofronte një shifër të saktë, pasi të dhënat e disponueshme nuk bëjnë dallim midis OJF-ve dhe kategorive të tjera të subjekteve aplikuese. OJF-të raportuan sfida në zbatimin praktik të përjashtimit nga TVSH-ja për grantet e financuara nga burime të jashtme, veçanërisht në lidhje me ofruesit privatë të shërbimeve. Sipas informacionit të mbledhur nga OJF-të, përfshirë edhe përmes diskutimit në fokus grup, ofruesit e shërbimeve ndonjëherë kanë ngurruar ose kanë refuzuar të zbatojnë përjashtimin për shkak të vetëdijes ose kuptimit të kufizuar të kërkesave përkatëse. Prandaj, OJF-të shpesh kanë pasur nevojë të shpjegojnë kërkesat dhe të ndihmojnë ofruesit në lundrimin e procesit. Kjo thekson nevojën për udhëzime të synuara dhe rritje të vetëdijes për bizneset e përfshira në zbatimin e përjashtimit nga TVSH-ja.

2.1.2. Stimujt për dhurimet

Kuadri ligjor në Shqipëri ofron stimuj të kufizuar tatimorë për dhurimet. Dhurimet nga subjektet tregtare rregullohen kryesisht përmes legjislacionit tatimor në fuqi dhe Ligjit për Sponsorizimet[50], i cili lejon zbritje brenda kufijve të përcaktuar prej 3 deri në 5 për qind për kategori specifike aktivitetesh, si kultura, arsimi dhe sporti. Megjithatë, ky kuadër nuk krijon një sistem gjithëpërfshirës stimujsh për kontributet filantropike, pasi përjashton fusha të caktuara me dobi publike, përfshirë demokracinë dhe të drejtat e njeriut, dhe nuk i njeh dhurimet nga individët për qëllime të zbritjes tatimore.

Në shkurt të vitit 2026 u prezantua projektligji "Për Donacionet dhe Sponsorizimet në Republikën e Shqipërisë",[51] i cili synon forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në rastet kur institucionet publike marrin dhurime dhe sponsorizime, si dhe rregullimin e sponsorizimeve që përfshijnë subjekte të tjera. Projektligji u hartua në kuadër të detyrimeve të Shqipërisë në procesin e integrimit evropian dhe si pjesë e një pakete më të gjerë legjislative kundër korrupsionit në sferën publike. Megjithatë, përfshirja e organizatave jofitimprurëse në fushën e zbatimit të tij ngriti shqetësime të konsiderueshme. Ndonëse projektligji synonte rritjen e

[50] Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994, "Për sponsorizimet", i ndryshuar me Ligjin nr. 9807, datë 20.09.2007. I disponueshëm: https://portavendore.al/wp-content/uploads/2018/05/Ligji-nr.7892-date-21.12.1994-Per-sponsorizimet.pdf
[51] Projektligji "Për dhurimet dhe sponsorizimet në Republikën e Shqipërisë", shpallur në shkurt 2026. I disponueshëm: https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/920

transparencës dhe llogaridhënies në veprimtarinë e organeve publike, ai parashikonte edhe detyrime për OJF-të, pavarësisht se këto organizata nuk ushtrojnë funksione të autoritetit publik dhe i nënshtrohen tashmë detyrimeve ekzistuese të raportimit dhe transparencës financiare. Në veçanti, përfshirja e OJF-ve në Regjistrin Kombëtar Elektronik të Donacioneve dhe Sponsorizimeve do të krijonte mbivendosje me mekanizmat ekzistues të raportimit, do të shtonte barrën administrative dhe mund të sillte kufizime joproporcionale në ushtrimin e lirisë së organizimit dhe në aksesin e tyre në burime financiare. Gjatë procesit të konsultimit, OJF-të u angazhuan në mënyrë aktive, duke paraqitur komente dhe rekomandime për këto dispozita dhe aspekte të tjera shqetësuese të projektligjit. Në kontributet e tyre, ato evidentuan ndikimet e mundshme të këtyre parashikimeve në sektorin jofitimprurës dhe propozuan ndryshime për adresimin e shqetësimeve të ngritura, me synim krijimin e një kuadri rregullator më proporcional dhe më mbështetës për shoqërinë civile.[52]

Deri në datën e përgatitjes së këtij raporti, nuk ekziston asnjë kornizë politikash për të nxitur bashkëpunimin e strukturuar midis OJF-ve dhe sektorit privat. "Albanian ESG Network",[53] i cili bashkon dhjetë nga kompanitë më të mëdha të vendit, mund të jetë tregues i një interesi në rritje në këtë fushë, veçanërisht duke pasur parasysh qëllimin e tij të deklaruar për të forcuar bashkëpunimin me qeverinë dhe partnerët ndërkombëtarë, megjithatë, rëndësia e tij praktike për bashkëpunimin midis OJF-ve dhe sektorit privat mbetet ende për t'u vlerësuar.

Të dhënat vjetore të monitorimit filantropik konfirmojnë rolin qendror të OJF-ve në ekosistemin filantropik të Shqipërisë, duke përbërë 58% të vlerës totale të dhurimeve si përfitues apo ndërmjetës.[54] Fushatat gjeneruan 97% të dhurimeve për OJF-të, ndërsa 99.24% e kontributeve ishin monetare. Kjo mbështetje, e përqendruar kryesisht në kontributet financiare të mbledhura përmes fushatave dhe me kontribute të kufizuara në natyrë, shërbime profesionale ose vullnetarizëm, dëshmon për një angazhim të kufizuar afatgjatë nga ana e donatorëve. Shumica e dhurimeve mbështetën grupet e margjinalizuara, lehtësimin e varfërisë, shëndetësinë dhe arsimin, duke reflektuar rolin e OJF-ve në adresimin e nevojave të paplotësuara sociale. Individët mbetën një burim kryesor i dhurimeve pavarësisht mungesës së stimujve tatimorë për dhurimet individuale.

2.2. Mbështetja e shtetit

2.2.1. Financimi Publik i Disponueshëm

Financimi publik për OJF-të në vend sigurohet përmes buxhetit të shtetit dhe kanalizohet nëpërmjet institucioneve të ndryshme publike, ku Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) shërben si mekanizmi kryesor për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë civile. Neni 16 i Ligjit për AMSHC-në përcakton se buxheti i AMSHC-së parashikohet si zë më vete në buxhetin vjetor të shtetit dhe nuk mund të jetë më i ulët se ai i vitit paraardhës. [55] Megjithatë, buxheti vjetor i shtetit nuk paraqet një të dhënë të konsoliduar mbi fondet publike të akorduara për OJF-të, pasi këto fonde shpërndahen përmes institucioneve dhe

[52] Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2026, "Komente dhe Rekomandime për projekligjin "Për donacionet dhe sponsorizimet". I disponueshëm: https://www.partnersalbania.org/News/comments-and-recommendations-on-the-draft-law-on-donations-and-sponsorships/

[53] Anëtarët e Albanian ESG Network: Titan Albania, Philip Morris International, Deloitte, Grant Thornton, Intracom, Coca-Cola Bottling Shqipëria, Balfin Group, Vodafone Albania, Kastrati Group, and Alumil. I disponueshëm: https://esgalbania.org/homepage

[54] Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2026, "Philanthropy Magazine". I disponueshëm: https://www.partnersalbania.org/wp-content/uploads/2025/07/Philanthropy_Magazine_Ed10.pdf

[55] Fletore Zyrtare nr. 37/2009, Ligji nr. 10093, datë 9.03 2009, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile". I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2009/03/09/10093

programeve të ndryshme, përfshirë AMSHC-në dhe ministritë e linjës. Për rrjedhojë, mungesa e një burimi të unifikuar të të dhënave nuk lejon identifikimin e lehtë të shumës totale të financimit publik të planifikuar për OJF-të, duke kufizuar transparencën dhe mundësinë për të vlerësuar nivelin e përgjithshëm të mbështetjes financiare publike për sektorin. Sa i përket financimit të administruar nga AMSHC-ja, buxheti i shtetit përfshin si fondet e destinuara për mbështetjen financiare të organizatave të shoqërisë civile, ashtu edhe shpenzimet operative të Agjencisë. Për rrjedhojë, nuk përcaktohet qartë pjesa e buxhetit që i dedikohet ekskluzivisht financimit të OJF-ve.

Kuadri ligjor dhe institucional parashikon pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile në strukturat drejtuese të AMSHC-së, përfshirë përfaqësimin në bordin drejtues, si dhe vendos bazat formale për konsultimin me OJF-të lidhur me prioritetet dhe programet e financimit. Kuadri ligjor trajton gjithashtu mekanizmat për parandalimin e konfliktit të interesit. Megjithatë, mekanizmat që sigurojnë pjesëmarrjen efektive të OJF-ve mbeten të pamjaftueshme në praktikë. Prioritetet e financimit orientohen nga agjenda dhe objektivat e qeverisë, ndërsa përfshirja e OJF-ve në mënyrë të rregullt dhe sistematike në proceset e monitorimit dhe vlerësimit mbetet për t'u përmirësuar. Ndryshime të mëtejshme në kuadrin institucional të AMSHC-së ishin gjithashtu në shqyrtim. Në shkurt 2026, u publikua për konsultim publik një projektligj për ndryshimin e ligjit për AMSHC-në. [56] Projektligji synonte ndryshimin e varësisë institucionale të Agjencisë, duke e kaluar atë nga Kryeministria në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në përputhje me rekomandimet e SIGMA-s lidhur me organizimin dhe koordinimin e administratës publike. Megjithatë, projektligji nuk adresonte angazhimet lidhur me Agjencinë, të përcaktuara në Udhërrëfyesin për Funksionimin e Institucioneve Demokratike.

N**ë** praktik**ë**, mbështetja financiare ofrohet kryesisht përmes granteve të bazuara në projekte, ndërsa financimi për zhvillimin institucional dhe mbulimin e kostove bazë e operacionale të organizatave mbetet i kufizuar. Po ashtu, bashkëfinancimi i projekteve të mbështetura nga BE-ja dhe donatorë të tjerë nuk mbështetet në mekanizma të qëndrueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga AMSHC-ja, në vitin 2025 mbështetja financiare për OJF-të arriti në 107,600,000 lekë (rreth 1.12 milionë euro), duke përfituar 75 organizata nga 160 aplikante. Kjo përbën një rritje prej 11.5% krahasuar me vitin 2024, kur u akorduan 96,500,000 lekë (rreth 1.01 milionë euro). Megjithatë, mbulimi i sektorit përmes kësaj skeme mbetet i kufizuar: organizatat përfituese përfaqësojnë vetëm rreth 3.1% të 2,412 OJF-ve aktive në vend. Këto të dhëna evidentojnë hendekun ndërmjet rolit të AMSHC-së si mekanizëm publik për mbështetjen e shoqërisë civile dhe shtrirjes faktike të financimit të ofruar.

Thirrja për propozime e AMSHC-së për vitin 2025 përfshiu një gamë të gjerë prioritetesh tematike. Qeverisja e mirë dhe lufta kundër korrupsionit përbënin 50.74% të buxhetit të përgjithshëm; përfshirja sociale, të drejtat e grave dhe fuqizimi i grupeve të margjinalizuara zinin 7.06%; zhvillimi ekonomik, punësimi dhe inovacioni - 10.5%; mbrojtja e mjedisit dhe tranzicioni i gjelbër - 9.8%; ndërsa kultura, arsimi, shëndetësia dhe trashëgimia kulturore - 11.9%. Pjesa e mbetur prej 10% u dedikua projekteve që trajtonin më shumë se një fushë prioritare. Ndonëse thirrja mbuloi fusha të ndryshme tematike, më shumë se gjysma e financimit u përqendrua te qeverisja e mirë dhe lufta kundër korrupsionit. Sipas AMSHC-së, ky përqendrim lidhej me zbatimin e kuadrove strategjike kombëtare, përfshirë Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, në të cilat qeverisja e mirë, lufta kundër korrupsionit dhe edukimi ligjor i publikut janë përcaktuar si prioritete strategjike kombëtare. Sa i përket bashkëfinancimit, AMSHC-ja konfirmoi se gjatë vitit

[56]Informacioni është marrë nga platforma qeveritare e konsultimeve. I disponueshëm: https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/936

2025 nuk u hap asnjë skemë e dedikuar për bashkëfinancimin e projekteve të mbështetura nga BE-ja apo donatorë të tjerë. Sipas përgjigjes, në rastet kur organizatat kanë paraqitur burime bashkëfinancimi, këto mund të kenë qenë pjesë e strukturës financiare të projekteve të propozuara.

Financimi publik për OJF-të ofrohet gjithashtu përmes institucioneve të tjera publike. Në vitin 2025, Ministria e Drejtësisë, përmes Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, vuri në dispozicion një fond prej 8,000,000 Lekësh (rreth 83,900 Euro) nga buxheti i shtetit për mbështetjen e OJF-ve të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti. Nga ky fond, 4,657,145 Lekë (rreth 48,800 Euro) u shpërndanë në bazë të propozimeve të paraqitura për financim. Në kuadër të kësaj skeme aplikuan tetë OJF, nga të cilat katër u përzgjodhën për financim përmes lidhjes së kontratave për ofrimin e shërbimeve. [57]

Gjithashtu, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Sportit mbështeti financiarisht OJF-të përmes skemës së granteve, duke vënë në dispozicion një fond prej 213,200,000 Lekësh (rreth 2.23 milionë Euro) nga buxheti i shtetit. Duhet theksuar se kjo shumë nuk përfaqëson ekskluzivisht financimin e akorduar për OJF-të, pasi thirrja ishte e hapur edhe për kategori të tjera subjektesh dhe individë. Në kuadër të thirrjes për financim aplikuan gjithsej 309 OJF, nga të cilat 143 u përzgjodhën për të përfituar mbështetje financiare.[58]

Financimi publik për shoqërinë civile u kanalizua gjithashtu përmes Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR). Në vitin 2025, në kuadër të Thirrjes Publike nr. V, AKR-ja mbështeti 32 projekte të zbatuara nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, me një vlerë totale prej 89,994,499 Lekësh (rreth 920,000 Euro).[59] Projektet u shtrinë në 42 bashki dhe pritej të përfshinin më shumë se 25,000 të rinj, duke mbështetur nisma në fusha të tilla si teknologjia dhe sipërmarrja, kultura dhe sporti, mirëqenia sociale dhe pjesëmarrja qytetare, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022–2029.[60]

Ndonëse financimi publik për OJF-të përfshin disa fusha tematike, shtrirja dhe mundësitë për përfitimin e tij mbeten të kufizuara, ndërsa mbështetja kanalizohet kryesisht përmes granteve për projekte, në përputhje me prioritetet e përcaktuara nga qeveria. Kjo mënyrë financimi nuk adreson në mënyrë të mjaftueshme nevojat institucionale dhe operacionale afatgjata të organizatave, veçanërisht mundësinë për të vijuar veprimtarinë përtej cikleve individuale të projekteve. Gjatë diskutimeve me ekspertë dhe në fokus-grupe, OJF-të theksuan se fondet publike të disponueshme nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar kostot e funksionimit dhe për të garantuar vazhdimësinë e veprimtarisë së tyre, veçanërisht në kushtet e tkurrjes së mbështetjes financiare nga donatorët e huaj. Këto kufizime janë veçanërisht të ndjeshme për organizatat që ofrojnë shërbime sociale për grupet e margjinalizuara, pasi veprimtaria e tyre kërkon financim të vazhdueshëm dhe nuk mund të mbështetet vetëm në grante afatshkurtra për projekte.

Sa i përket përfshirjes së OJF-ve në përcaktimin e prioriteteve të financimit, AMSHC-ja zhvilloi një proces konsultimi në kuadër të përgatitjes së thirrjes për projekt propozime. Në këtë kuadër, u organizuan gjashtë takime konsultuese me organizatat e shoqërisë civile në Vlorë, Berat, Korçë/Pogradec, Kukës, Shkodër dhe Tiranë.[61] Organizatat që nuk patën mundësi të merrnin pjesë në takime u ftuan të përcillnin sugjerimet e tyre me shkrim. Sipas përgjigjes së AMSHC-së, gjetjet dhe propozimet e dala nga ky proces konsultimi u mblodhën

[57] Të dhënat u morën në përgjigje të kërkesës për informacion të paraqitur nga Partnerët Shqipëri.
[58] Të dhënat u morën në përgjigje të kërkesës për informacion të paraqitur nga Partnerët Shqipëri.
[59] Agjencia Kombëtare e Rinisë, 2025. I disponueshëm: https://rinia.gov.al/wp-content/uploads/2025/08/lista-fituese-thirrja-V-web.pdf
[60] Agjencia Kombëtare e Rinisë, 2025, "Nënshkrimi i kontratave me Organizatat Fituese të thirrjes V," I disponueshëm: https://rinia.gov.al/nenshkrimi-i-kontratave-me-organizatat-fituese-te-thirrjes-v/
[61] Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, 2025 "Ditari Nr. 32, Janar - Qershor 2025", fq. 5–6. I disponueshëm: https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2025/07/AMSHC-Ditar_janar-qershor-2025.pdf

me synimin për t'u marrë në konsideratë gjatë hartimit të thirrjes për propozime.[62] Megjithatë, thirrja përfundimtare vijoi të mbështetej në prioritetet strategjike të përcaktuara nga qeveria. Ndonëse përfshinte pesë fusha të gjera tematike, ajo parashikonte shprehimisht se përparësi do t'u jepej projekt-propozimeve që kontribuonin në përmbushjen e treguesve të përcaktuar në strategjitë e miratuara nga qeveria.[63] Ndërkohë, AKR organizoi dy sesione informuese online për organizatat aplikonte të mundshme. Këto sesione synonin të lehtësonin pjesëmarrjen e OJF-ve në procedurat e aplikimit për financim, dhe jo përfshirjen e tyre në përcaktimin e prioriteteve të financimit.[64]

Përveç financimit nga qeverisja qendrore, financimi publik për OJF-të ofrohet edhe në nivel vendor, megjithëse disponueshmëria dhe shtrirja e tij ndryshojnë ndjeshëm nga një bashki në tjetrën. Nga 41 bashkitë që iu përgjigjën kërkesës për informacion të Partnerëve Shqipëri, 8 prej tyre (19%) raportuan se kishin ofruar mbështetjeje financiare për OJF-të gjatë vitit 2025. Shumat totale e shpërndara ndryshojnë ndjeshëm, duke filluar nga 100,000 Lekë (afërsisht 1,000 Euro) në Bashkinë Gramsh, deri në 44.5 milionë Lekë (afërsisht 464,000 Euro) në Bashkinë Shkodër. Në rastet kur të dhënat ishin të disponueshme, nga dy deri në tre OJF për bashki përfituan grante. Megjithatë, disa bashki nuk ofruan informacion të plotë lidhur me thirrjet për aplikime, numrin e aplikimeve të paraqitura apo vlerën individuale të granteve.

Tabela 1: Financimi publik nga institucionet publike në nivel vendor gjatë vitit financiar 2025.

Bashkia	Numri i Thirrjeve	Numri total i Aplikimeve	OJF-të fituese	Minimumi dhe maksimumi i granteve	Shuma totale e shpërndare në 2025
Patos	1	4	2	Min.: 1,200,000 Lekë (afërsisht 12,600 Euro) Maks.: 1,800,000 Lekë (afërsisht 18,800 Euro)	3,000,000 Lekë (afërsisht 31,400 Euro)
Gramsh	N/A	N/A	N/A	N/A	100,000 LEKË (approx. EUR 1,000)
Përmet	1	3	3	Min.: 1,000,000 Lekë (afërsisht 10,500 Euro) Maks.: 2,000,000 LEKË (afërsisht 20,900 Euro)	6,000,000 Lekë (afërsisht 62,800 Euro)
Lezhë	1	5	2	N/A	4,000,000 Lekë (afërsisht 41,800 Euro)
Shkodër	N/A	N/A	2	Min.: 19,530,000 Lekë (afërsisht 203,000 Euro) Maks.: 24,970,000 Lekë (afërsisht 260,000 Euro)	44,500,000 Lekë (afërsisht 464,000 Euro)

[62] Ibid, fq. 6
[63] Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, 2025, "Thirrja Nr. 18 për Projekt Propozime". I disponueshëm: https://amshc.gov.al/thirrje-nr-18-per-projekt-propozime-13-maj-2025-deri-13-qershor-2025/
[64] Agjencia Kombëtare e Rinisë, 2025, "Sesion Informimi Online për Thirrjen Nr. V për Projekt Propozime të organizatave dhe të rinjtë". I disponueshëm: https://rinia.gov.al/en/sesionet-informuese-online-per-thirrjen-publike-nr-v-per-projekt-propozime-per-organizatat-rinore-dhe-per-te-rinjte/

Kamëz	1	6	2	N/A	3,000,000 Lekë (afërsisht EUR 31,400)
Mat	N/A	N/A	2	Min.: 480,000 LEKË (afërsisht 5,000 Euro) Maks.: 2,850,000 Lekë (afërsisht 29,800 Euro)	3,330,000 Lekë (afërsisht 34,800 Euro)
Kukës	1	7	2	N/A	900,000 Lekë (afërsisht 9,400 Euro)

2.2.2. Shpërndarja e Financimit Publik

Shpërndarja e financimit publik për OJF-të rregullohet me ligj, por është i fragmentuar. Në rastin e AMSHC-së, dhënia e granteve rregullohet nga Ligji nr. 10093/2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", nga statuti i saj, i ndryshuar, si dhe nga aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme në zbatim të tyre.[65] Këto përcaktojnë bazën institucionale për shpalljen e thirrjeve për propozime, paraqitjen dhe vlerësimin e aplikimeve, përzgjedhjen e projekteve dhe lidhjen e kontratave me përfituesit.[66] Informacioni mbi thirrjet për projekt propozime dhe prioritetet e financimit bëhet publik paraprakisht, duke rritur transparencën dhe parashikueshmërinë e procesit. Megjithatë, ky nivel rregullimi zbatohet kryesisht për financimin e administruar nga AMSHC-ja. Financimi publik i OJF-ve nga ministritë dhe institucionet e tjera publike rregullohet përmes urdhrave të veçantë të ministrive përgjegjëse, të cilat përcaktojnë procedurat dhe kriteret përkatëse të financimit. Si rezultat, procedurat e përzgjedhjes, afatet kohore, praktikat e publikimit të informacionit, si dhe mundësitë për rishikim ose ankim ndryshojnë ndërmjet skemave të financimit, dhe mungon një kalendar i unifikuar i thirrjeve për projekt propozime ose një mekanizëm i konsoliduar raportimi që të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të mundësive të financimit dhe granteve të akorduara.

Adresimi i këtyre mangësive është parashikuar përmes masave konkrete në Udhërrëfyesin për Funksionimin e Institucioneve Demokratike.[67] Udhërrëfyesi parashikon përmirësimin, deri në fund të vitit 2025, të procedurave administrative për menaxhimin e fondeve publike që mbështesin shoqërinë civile, përfshirë ato të administruara nga AMSHC-ja. Ai parashikon gjithashtu vënien e plotë në funksion të platformës online për monitorimin e procedurave të granteve deri në fund të vitit 2025, si dhe rritjen e financimit publik nga viti 2026, me qëllim forcimin e kapaciteteve të OJF-ve për të përmbushur rolin e tyre si ofruese shërbimesh. Megjithatë, zbatimi i masave të planifikuara për t'u përfunduar gjatë vitit 2025 vijon të jetë në proces. Sipas informacionit të dhënë nga AMSHC-ja gjatë intervistës së zhvilluar në kuadër të këtij raporti, platforma online për monitorimin

[65] Fletore Zyrtare nr. 37/2009, Ligji nr. 10093, datë 9.3.2009, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile". I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2009/03/09/10093; Vendimi nr. 769, datë 15.7.2009, "Për miratimin e Statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile". I disponueshëm: https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2026/04/vendim-2009-07-15-769-statuti-i-amshc.pdf

[66] Informacioni është marrë nga faqja e internetit të AMSHC-së. I disponueshëm: https://amshc.gov.al/thirrje-nr-18-per-projekt-propozime-13-maj-2025-deri-13-qershor-2025/

[67] Fletore Zyrtare 168/2024, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 611, datë 2.10.2024, "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike". I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/10/02/611

e granteve është ende në fazën e zhvillimit. AMSHC-ja bëri me dije se Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, institucioni përgjegjës për zhvillimin teknik të platformës, është duke udhëhequr këtë proces.[68]

Masat mbrojtëse ndaj konfliktit të interesit përcaktohen përmes kuadrit të përgjithshëm ligjor që zbatohet për zyrtarët publikë. Ligji nr. 9367/2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, përcakton rregullat për identifikimin, deklarimin, parandalimin dhe trajtimin e konflikteve të interesit në vendimmarrjen publike.[69] Këto masa plotësohen, në kuadër të procedurave individuale të financimit, me kërkesa specifike që synojnë të garantojnë paanshmërinë në procesin e përzgjedhjes. Në rastin e AMSHC-së, dokumentacioni i aplikimit për Thirrjen për Projekt Propozime përfshin një deklaratë të posaçme mbi konfliktin e interesit.[70] Këto kërkesa kontribuojnë në forcimin e parandalimit dhe trajtimit të konfliktit të interesit. Megjithatë, efektiviteti i tyre lidhet ngushtë me zbatimin e njëtrajtshëm gjatë procesit të vlerësimit dhe vendimmarrjes.

Shkalla e publikimit të informacionit mbi vendimet e financimit ndryshon nga një institucion në tjetrin. Megjithatë, asnjë nga institucionet kryesore financuese të shqyrtuara nuk përmbush plotësisht standardin minimal të transparencës, i cili kërkon publikimin e emrave të organizatave përfituese, shumave të akorduara, si dhe informacionit të mjaftueshëm mbi qëllimin dhe aktivitetet e projekteve të financuara. AMSHC-ja publikon emrat e organizatave përfituese dhe informacionin mbi shumat e akorduara, dhe kohështrirjen, por nuk përfshin të dhëna mbi objektivat dhe aktivitetet e projekteve të financuara [71]. Ministria e Kulturës, Turizmit dhe Sportit publikon informacion mbi organizatat përfituese dhe projektet e mbështetura, por informacioni i disponueshëm nuk përfshin gjithmonë të gjitha të dhënat financiare dhe përmbajtësore të nevojshme për të identifikuar plotësisht financimin e akorduar për secilin projekt.[72] AKR-ja publikon titujt e projekteve fituese dhe shumat e financimit të akorduara për to, por nuk publikon emrat e organizatave përfituese. Në rastin e Ministrisë së Drejtësisë, transparenca sigurohet pjesërisht nëpërmjet publikimit të regjistrit të OJF-ve të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti. Regjistri përmban informacion mbi organizatat përfituese, shtrirjen e tyre gjeografike dhe, sipas rastit, kontratat e financimit. Megjithatë, në këtë regjistër nuk publikohet në mënyrë sistematike shuma e financimit të përfituar nga secila organizatë, apo informacion i detajuar mbi aktivitetet dhe rezultatet e financuara.[73] Këto praktika dëshmojnë mungesën e një standardi të përbashkët për publikimin e informacionit mbi financimin publik për OJF-të.

Efektiviteti i mekanizmave për kundërshtimin e vendimeve të financimit mbetet i vështirë për t'u vlerësuar. Sipas informacionit të dhënë nga AMSHC-ja, gjatë procedurës së financimit për vitin 2025 u paraqitën dy ankesa, por asnjëra prej tyre nuk solli rivlerësimin e tyre.[74] Nga intervistat dhe diskutimet në fokus-grupe

[68] Informacion i dhënë nga përfaqësuesit e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile gjatë një interviste të zhvilluar nga Partnerët Shqipëri.
[69] Fletore Zyrtare 31/ 2005, Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2005/04/07/9367
[70] Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Thirrja nr. 18 për Projekt-Propozime, dokumentacioni i aplikimit, përfshirë Deklaratën e Konfliktit të Interesit. I disponueshëm: https://amshc.gov.al/thirrje-nr-18-per-projekt-propozime-13-maj-2025-deri-13-qershor-2025/
[71] Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Vendim Nr. 3, datë 07.07.2025 "Për miratimin e Projekt-Propozimeve dhe shumat e financimit me grant për secilin nga fituesit". I disponueshëm: https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2025/07/Vendimi-nr-03-date-07.07.2025 .pdf
[72] Informacioni është marrë nga faqja e Ministrisë. I disponueshëm: https://turizmi.gov.al/njoftim-mbi-thirrjen-per-mbeshtetje-financiare-te-projekteve-ne-turizem-per-vitin-2025-2
[73] Ministria e Drejtësisë, "Lista me 14 OJF të autorizuara për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore". I disponueshëm: https://www.drejtesia.gov.al/lista-e-ojf-ve-14-ojf-te-autorizuara-nga-ministri-i-drejtesise-per-ofrimin-e-sherbimit-te-ndihmes-juridike-paresore/
[74] Informacioni është marrë nëpërmjet një kërkese për informacion të paraqitur nga Partnerët Shqipëri.

rezultoi se disa OJF vendosën të mos aplikojnë për financim publik, për shkak të shqetësimeve mbi paanshmërinë dhe efektivitetin e procedurave të financimit.

Aksesueshmëria e financimit nga AMSHC-ja ndikohet gjithashtu nga kërkesat administrative që u vendosen organizatave. Dokumentacioni i kërkuar në kuadër të thirrjes për projekt-propozime përfshin një numër të konsiderueshëm dokumentesh dhe deklaratash ligjore, financiare dhe administrative, përveç vetë projekt-propozimit. Në thirrje theksohet shprehimisht se mosparaqitja qoftë edhe e një dokumenti të vetëm, në formën e përcaktuar, sjell skualifikimin automatik të aplikimit. Organizatave u kërkohet të paraqesin, ndër të tjera, dokumente që vërtetojnë regjistrimin dhe statusin ligjor të organizatës, përmbushjen e detyrimeve tatimore, të dhënat bankare, si dhe një sërë deklaratash. Në varësi të rastit, kërkohet edhe dokumentacion shtesë. Disa dokumente duhet të jenë të lëshuara së fundmi dhe/ose të paraqiten në origjinal apo në formë të njësuar me origjinalin. Ndonëse këto kërkesa i shërbejnë qëllimeve legjitime të verifikimit të kritereve të pranueshmërisë dhe garantimit të llogaridhënies, efekti i tyre i kombinuar mund të krijojë një barrë administrative joproporcionale, veçanërisht për organizatat më të vogla, me staf dhe burime të kufizuara, si dhe për organizatat që ndodhen jashtë Tiranës. Kërkesa për të siguruar dokumente të caktuara gjyqësore në Tiranë e rrit më tej kohën dhe kostot e procesit.

Në nivel vendor, transparenca në shpërndarjen e financimit publik për OJF-të mbetet e pabarabartë, duke reflektuar larminë e mekanizmave dhe praktikave të financimit në bashki të ndryshme. Një qasje më e strukturuar është zbatuar përmes programit ReLOaD dhe metodologjisë së tij LOD,[75] e cila promovon thirrje të hapura për propozime, pjesëmarrjen e shoqërisë civile në përcaktimin e prioriteteve të financimit, procedura transparente të vlerësimit, si dhe publikimin e informacionit mbi vendimet e financimit.[76] Megjithatë, kjo praktikë nuk zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha bashkitë dhe as për të gjitha format e mbështetjes që bashkitë u ofrojnë OJF-ve. Financimi mund të ofrohet gjithashtu nëpërmjet kontratave të shërbimit, transfertave ose formave të tjera të bashkëpunimit të drejtpërdrejtë.

2.2.3. Llogaridhënia në Përdorimin e Financimit Publik

Kuadri ligjor përcakton kërkesa për llogaridhënien dhe monitorimin në shpërndarjen e fondeve publike për OJF-të. Ligji nr. 10093/2009, aktet e tij zbatuese dhe kontratat që rregullojnë grantet e përfituara përcaktojnë detyrimet lidhur me zbatimin e projekteve të financuara, përdorimin e fondeve, raportimin dhe monitorimin. OJF-të janë të detyruara të zbatojnë aktivitetet dhe të kryejnë shpenzimet në përputhje me projektin dhe buxhetin e miratuar, si dhe të përmbushin kërkesat për raportimin narrativ dhe financiar. Monitorimi është pjesë e ciklit të financimit dhe përfshin shqyrtimin e zbatimit të projekteve dhe përputhshmërisë financiare, të plotësuar, sipas rastit, me monitorimin në terren. Raporti Vjetor i AMSHC-së për vitin 2025 konfirmon se gjatë këtij viti është kryer monitorimi në terren i projekteve të financuara. Kërkesa të ngjashme për llogaridhënie

[75] ReLOaD është akronimi i Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor. Metodologjia e tij për Demokracinë Vendore (LOD) përcakton procedura transparente, konkurruese dhe llogaridhënëse për shpërndarjen e fondeve të pushtetit vendor për organizatat e shoqërisë civile. Programi financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Më shumë informacion gjendet në: https://www.undp.org/albania/projects/regional-programme-local-democracy-western-balkans-reload

[76] Bashkitë, përfshirë Tiranën, Shkodrën, Lushnjën, Sarandën, Kavajën, Kukësin, Patosin dhe Kamzën, e kanë miratuar zyrtarisht metodologjinë LOD.

mund të zbatohen edhe në skemat e financimit të administruara nga institucione të tjera publike, nëpërmjet marrëveshjeve kontraktore specifike që rregullojnë secilën skemë.

Kuadri ligjor parashikon gjithashtu mekanizma për trajtimin e parregullsive në administrimin dhe përdorimin e fondeve publike. Ligji nr. 10296/2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, përcakton kuadrin e përgjithshëm për menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm dhe llogaridhënien në njësitë e sektorit publik.[77] Ndërsa Ligji nr. 112/2015, "Për inspektimin financiar publik", përcakton kuadrin për kryerjen e inspektimeve financiare në rastet kur konstatohen parregullsi në lidhje me fondet publike.[78] Në rastin e financimit nga AMSHC-ja, organizatat përfituese janë të detyruara, në bazë të kontratës, t'i përdorin fondet për qëllimin e miratuar dhe në përputhje me projektin dhe buxhetin e dakordësuar. Në varësi të natyrës së mospërputhjes dhe dispozitave kontraktore të zbatueshme, masat mund të përfshijnë pezullimin ose ndërprerjen e financimit, si dhe rikuperimin e fondeve të dhëna. Kur parregullsitë përbëjnë gjithashtu vepra të dënueshme sipas legjislacionit në fuqi, zbatohen dispozitat ligjore përkatëse.

Sipas pjesëmarrësve në fokus-grupin me OJF-të që përfituan financim nga AMSHC-ja në vitin 2025, projektet ishin subjekt i monitorimit të rregullt dhe organizatat kishin marrë komente me shkrim nga Agjencia lidhur me zbatimin e tyre. Në përgjithësi, pjesëmarrësit e vlerësuan pozitivisht procesin e monitorimit. Nga ana tjetër, Raporti Vjetor i AMSHC-së për vitin 2025 paraqet të dhëna të agreguara mbi aktivitetet e monitorimit, por nuk ofron informacion të detajuar që të mundësojë përcaktimin e përqindjes së projekteve të monitoruara në terren për secilën thirrje financimi.

Megjithatë, duhet bërë dallim midis monitorimit të granteve individuale dhe vlerësimit të efektivitetit dhe ndikimit të përgjithshëm të programeve të financimit publik. Në institucionet që ofrojnë mbështetje financiare, mekanizmat e monitorimit janë përgjithësisht të përqendruar te çështja nëse aktivitetet e financuara zbatohen në përputhje me propozimin e miratuar, buxhetin dhe kërkesat kontraktuale. Në rastin e AMSHC-së, korniza rregullatore në fuqi parashikon raportimin financiar dhe kontrollin e projekteve të financuara nga Agjencia, ndërsa Raporti Vjetor dokumenton monitorimin e zbatimit të granteve dhe raporton mbi shpërndarjen e tyre sipas fushave prioritare dhe shtrirjes gjeografike. Megjithatë, dokumentacioni i disponueshëm i shqyrtuar për këtë raport nuk dëshmon një praktikë përkatëse të vlerësimit periodik të skemës së granteve në nivel programi. Në veçanti, nuk u identifikua asnjë vlerësim publik mbi rezultatet e projekteve të financuara për të vlerësuar efektivitetin e përgjithshëm, rezultatet afatgjata ose qëndrueshmërinë e mbështetjes financiare të Agjencisë, dhe që të tregojë se si këto gjetje ndikojnë në prioritetet e financimit dhe vendimet për dhënien e granteve.

E njëjta problematikë konstatohet edhe në rastin e fondeve të administruara nga AKR-ja. Ndonëse Agjencia vepron në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, e cila ka një sistem të strukturuar monitorimi, ky proces nuk përbën domosdoshmërisht vlerësim të efektivitetit të programit të granteve. Shqyrtimi i dokumentacionit nuk evidentoi publikimin e vlerësimeve periodike në nivel programi, që të analizojnë nëse financimi i akorduar për organizatat rinore ka kontribuar në arritjen e rezultateve të synuara, sa të qëndrueshme kanë qenë këto rezultate dhe nëse përvoja e projekteve të përfunduara është përdorur për përmirësimin e thirrjeve të mëvonshme për financim.

[77] Fletore Zyrtare 97/2010, Ligji. Nr. 10296, date 8.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2010/07/08/10296

[78] Fletore Zyrtare 186/2015, Ligji. Nr.112/2015, datë 15.10 2015, "Për inspektimin financiar publik". I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/10/15/112

Për Ministrinë e Drejtësisë, monitorimi dhe raportimi janë pjesë përbërëse e ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Raportimi i Ministrisë mbi monitorimin përfshin veprimtarinë e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe mbështetjen financiare të katër OJF-ve nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore gjatë vitit 2025.[79] Megjithatë, raportimi lidhet kryesisht me zbatimin e sistemit të ndihmës juridike, masat institucionale dhe ofrimin e shërbimeve. Shqyrtimi i dokumentacionit nuk evidentoi ndonjë vlerësim të veçantë, të publikuar, mbi efektivitetin dhe ndikimin e financimit të OJF-ve si mekanizëm për ofrimin e ndihmës juridike parësore. Në veçanti, mungon një analizë e kontributit të këtij financimi në përmirësimin e aksesit në shërbime, si dhe e qëndrueshmërisë dhe vlerës së shtuar të shërbimeve të ofruara nga OJF-të.

Në rastin e skemave të granteve të administruara nga ministria përgjegjëse për kulturën, turizmin dhe sportin, dokumentacioni i shqyrtuar përmban informacion mbi fondet e akorduara, projektet e financuara dhe organizatat përfituese. Megjithatë, nuk u identifikuan vlerësime periodike në nivel programi që të shqyrtojnë efektivitetin e këtyre skemave. Për rrjedhojë, ndërsa dokumentacioni mundëson ndjekjen e vendimeve individuale të financimit dhe të zbatimit të projekteve, ai ofron pak informacion mbi rezultatet e përgjithshme të financimit, qëndrueshmërinë e tyre dhe mënyrën se si këto rezultate përdoren për të përmirësuar skemat e mëtejshme të granteve.

Në nivel vendor, monitorimi i financimit të OJF-ve mbetet kryesisht i përqendruar te zbatimi i projekteve individuale dhe përputhshmëria me kushtet kontraktuale. Megjithëse programi ReLOaD, i mbështetur nga BE dhe zbatuar nga UNDP ka prezantuar mekanizma më të strukturuar monitorimi dhe vlerësimi përmes metodologjisë LOD, këto praktika nuk dëshmojnë institucionalizimin e vlerësimit periodik nga bashkitë të efektivitetit dhe ndikimit të financimit të akorduar nga buxhetet e tyre. Rishikimi dokumentar dhe përgjigjet e bashkive nuk evidentuan vlerësime sistematike të rezultateve dhe efekteve afatgjata të këtij financimi.

2.2.4. Mbështetja Jo-financiare

Mbështetja publike jofinanciare për OJF-të nuk rregullohet nga një kuadër i vetëm gjithëpërfshirës, por mbështetet në dispozita të legjislacionit sektorial dhe në praktika të ndryshme institucionale. Në sektorin kulturor, Ligji nr. 10352/2010 "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar, përcakton kuadrin e gjerë për politikat publike dhe veprimtarinë institucionale.[80] Një mekanizëm më specifik parashikohet në ligjin nr. 34/2019, "Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara", i ndryshuar, i cili mundëson përdorimin e këtyre pasurive për qëllime sociale dhe në funksion të interesit publik.[81] Ky kuadër është relativisht më i strukturuar: VKM nr. 888/2020 përcakton kriteret dhe procedurat për dhënien në përdorim dhe tjetërsimin e tyre.[82] Për format e tjera të ndihmës jo financiare nuk ekziston asnjë grup rregullash i harmonizuar, ndaj kushtet e aksesit, procedurat dhe informacioni publik ndryshojnë nga institucioni te institucioni.

[79] Ministria e Drejtësisë, 2026, *"Raporti i Monitorimit 2025"*. I disponueshëm: https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2026/07/Raporti-i-Monitorimit-per-vitin-2025.pdf

[80] Fletore Zyrtare 166/2010, Ligji Nr. 10352, date 18.11.2010, "Mbi artin dhe kulturën", as amended. Available at: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2010/11/18/10352

[81] Fletore Zyrtare 99/2019, Ligji nr. 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara", i ndryshuar. Available at: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2019/06/17/34

[82] Fletore Zyrtare 201/2020. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 888, datë 11.11.2020 "Për përcaktimin e kritereve, metodave dhe procedurave të vlerësimit për dhënien në përdorim dhe tjetërsimin e pasurive të konfiskuara'. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/11/11/888

Zbatimi i mekanizmit të ripërdorimit social u konkretizua edhe gjatë vitit 2025, kur AAPSK-ja shpalli një thirrje publike për propozime, ku mund të aplikonin edhe OJF-të.[83] Nga rreth 30 aplikime të paraqitura, 22 ishin nga OJF-të, ndërsa tre subjekte u shpallën fituese.[84] Sipas përgjigjes së marrë nga AAPSK-ja, dy nga fituesit e zgjedhur ishin OJF, të cilave iu dha përdorimi i pronave të konfiskuara për qëllime sociale. Pronat synohej të shndërroheshin përkatësisht në një hapësirë kulturore dhe komunitare dhe në një qendër që ofron shërbime riintegrimi për grupet e cenueshme.

Në nivel qendror, informacioni i mbledhur për këtë raport tregon se mbështetja jofinanciare ofrohet nga disa institucione publike, megjithëse forma dhe shtrirja e saj ndryshojnë. Sipas informacionit të dhënë nga ASCS, në vitin 2025 Agjencia mbështeti OJF-të përmes informimit, orientimit dhe asistencës teknike gjatë zbatimit të projekteve. Ministria përgjegjëse për kulturën raportoi gjithashtu se ofroi mbështetje jofinanciare për OJF-të gjatë periudhës raportuese, krahas mbështetjes së saj financiare.

Në nivel vendor, ndihma jofinanciare është më e përhapur sesa mbështetja financiare. Përgjigjet e marra nga bashkitë tregojnë se mbështetja merr forma të ndryshme, përfshirë ofrimin ose përdorimin e përkohshëm të ambienteve dhe pajisjeve, ndihmën logjistike dhe teknike, mbështetjen me staf dhe bashkëpunimin institucional në organizimin e takimeve, trajnimeve dhe aktiviteteve komunitare.[85]

Nga perspektiva e OJF-ve të intervistuara, qasja në mbështetjen jofinanciare perceptohej relativisht e thjeshtë. Ato nuk raportuan pengesa administrative të rëndësishme kur kërkuan mbështetje si hapësira për takime ose trajnime, ndihmë logjistike apo koordinim institucional.

2.3. Kapitali njerëzor

2.3.1. Punësimi në OJF

Kuadri ligjor nuk përcakton një regjim të veçantë punësimi për OJF-të. Marrëdhëniet e punës rregullohen nga Kodi i Punës, i ndryshuar,[86] sipas të njëjtave rregulla të përgjithshme që zbatohen për punëdhënësit e tjerë. Kuadri për masat e promovimit të punësimit ofron gjithashtu mundësi për pjesëmarrjen e OJF-ve. Në veçanti, programi i punëve publike komunitare përfshin shprehimisht OJF-të dhe organizatat e shoqërisë civile në mesin

[83] Informacioni është marrë nga faqja zyrtare në Facebook e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. I disponueshëm: https://www.facebook.com/aapskalbania/posts/-thirrje-publike-p%C3%ABr-projekt-ide-p%C3%ABr-rip%C3%ABrdorimin-social-t%C3%AB-pasurive-t%C3%AB-konfisku/1158330406320491/

[84] Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, 2026 "Raporti Vjetor 2025", fq. 29. I disponueshëm: https://aapsk.gov.al/wp-content/uploads/2026/02/Raporti-2025-Final.pdf. Sipas përgjigjes së marrë nga Agjencia, 22 nga 30 aplikimet gjithsej u dorëzuan nga OJF-të.

[85] Bashkitë në të gjithë Shqipërinë raportojnë nivele të ndryshme të mbështetjes jofinanciare për OJF-të. Cërriku ofroi mbështetje jofinanciare për 15 organizata përmes ambienteve dhe bashkëpunimit institucional brenda Qendrës Komunitare Shumëfunksionale, e bashkëfinancuar nga BE-ja përmes UNICEF-it dhe World Vision. Kamza siguroi mbështetje jofinanciare për 6 OJF, përfshirë përdorimin e Pallatit të Kulturës dhe të Shtëpisë së Rinisë, së bashku me asistencë teknike dhe koordinim. Roskoveci vuri në dispozicion ambiente pa pagesë, si dhe mbështetje logjistike për Grupin Vendor të Veprimit, duke kombinuar mbështetjen financiare dhe jofinanciare. Përmeti ofroi ambiente, pajisje dhe staf mbështetës sipas nevojave të organizatave, pa kontrata financiare shtesë. Lezha bashkëpunoi me OJF-të duke vënë në dispozicion ambiente për takime dhe trajnime në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Në Pustec, 2 OJF përfituan nga ambientet, pajisjet dhe stafi i bashkisë, pa asnjë procedurë të dokumentuar zyrtarisht. Mallakastra vuri në dispozicion ambiente publike dhe koordinoi aktivitete komunitare, pa kontrata apo procedura formale. Puka ofroi infrastrukturë dhe mbështetje logjistike, përfshirë sallat dhe personelin, për 5 organizata, pa marrëveshje formale. Lushnja mbështeti 8 organizata me ambiente dhe trajnime, pa mekanizma të formalizuar. Dropulli dhe Belshi raportuan vetëm mbështetje bazë logjistike.

[86] Ligji Nr. 7961, date 12.07.1995, "Kodi i Punës I Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. I disponueshëm: https://qbz.gov.al/preview/c1c18a6c-5f3e-457d-b931-de505b3c7ed0

e punëdhënësve të pranueshëm, me kusht që të plotësojnë kërkesat zbatuese të pranueshmërisë dhe ato administrative.[87]

Përcaktimi i numrit të personave të punësuar në sektorin e OJF-ve mbetet i vështirë për shkak të mungesës së të dhënave publike të përditësuara dhe specifike për këtë sektor. Në përgjigje të një kërkese për informim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve bëri me dije se të dhënat mbi punësimin publikohen në faqen e saj zyrtare. Megjithatë, nga shqyrtimi i faqes nuk u identifikuan të dhëna të veçanta mbi numrin e personave të punësuar në OJF në vitin 2025. [88] Për rrjedhojë, mungesa e të dhënave të tilla kufizon mundësinë për të vlerësuar madhësinë dhe strukturën e punësimit në sektor, si dhe ndryshimet e tij ndër vite.

Informacioni i dhënë nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe e Aftësive ofron evidenca lidhur me qasjen e OJF-ve në skemat publike të mbështetjes për punësim. Sipas përgjigjes së marrë nga AKPA, 135 subjekte morën pjesë në skemat përkatëse të mbështetjes për punësim në vitin 2025. Prej tyre, 43 OJF aplikuan nga të cilat 35 fituan, përafërsisht 81% të aplikuesve ishin OJF. Aplikimet u refuzuan për shkak të dokumentacionit të paplotë, në përputhje me kërkesat në fuqi. Intervistat e zhvilluara me OJF që kishin aplikuar ose përfituar nga këto programe nuk treguan trajtim të diferencuar në krahasim me punëdhënësit e tjerë pjesëmarrës.

Punësimi në sektorin e OJF-ve u ndikua gjithashtu nga ndryshimet në mjedisin e financimit në vitin 2025. Pezullimi i përkohshëm i ndihmës së huaj të SHBA-së, së bashku me ndryshimin e përparësive të donatorëve të tjerë, shtoi presionin financiar mbi OJF-të. Sipas intervistave me përfaqësues të OJF-ve, veçanërisht ofrues të shërbimeve sociale, disa organizata ulën numrin e stafit ose shkurtuan kontratat e punës për shkak të kufizimeve në financim.

2.3.2. Vullnetarizmi tek OJF-të

Në dhjetor 2025, Parlamenti miratoi Ligjin nr. 94/2025 "Për vullnetarizmin", i cili abrogoi Ligjin nr. 45/2016.[89] Ligji synon të krijojë një kuadër mundësues për vullnetarizmin dhe rregullon angazhimin afatshkurtër dhe afatgjatë, përfshirë të drejtat dhe detyrimet e vullnetarëve dhe të ofruesve të vullnetarizmit, marrëveshjet kontraktore, dhe rimbursimin e shpenzimeve të nevojshme. Gjithashtu, ai parashikon një bazë ligjore për mbështetjen shtetërore, duke u lejuar ofruesve të pranueshëm të vullnetarizmit të marrin subvencione për kostot e lidhura me vullnetarët, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e programit. Procedurat dhe kriteret e hollësishme për këtë mbështetje do të përcaktohen me akte nënligjore.

Megjithatë, informacioni i mbledhur për këtë raport nuk identifikoi asnjë program vullnetarizmi apo skemë nxitëse të mbështetur nga shteti që të ishte funksionale në vitin 2025, dhe OJF-të e konsultuara nuk raportuan të kishin marrë një mbështetje të tillë. Kjo është në përputhje me kohën e reformës, pasi Ligji nr. 94/2025, që parashikon bazën ligjore për subvencionet shtetërore për vullnetarizmin, hyn në fuqi më 2026.

Gjatë procesit legjislativ, OJF-të ngritën shqetësime për disa elemente të kuadrit të ri. Ato kërkuan një dallim më të qartë midis vullnetarizmit dhe punësimit, që të shmangej zbatimi i detyrimeve tatimore dhe sigurimeve

[87] Fletore Zyrtare Nr. 130/2020, VKM. Nr 535, datë 8.07.2020, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat e zbatimit të Programit të Punëve Publike Komunitare", i ndryshuar", i ndryshuar, fq. 7710, kapitulli III, para. 4. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/07/08/535
[88] Informacioni u mor përmes një kërkese për informim të paraqitur nga Partnerët Shqipëri.
[89] Fletore Zyrtare 15/2026. Ligji Nr. 94/2025 "Për vullnetarizmit". I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2025/12/18/94

shoqërore që nuk i përshtaten natyrës së vullnetarizmit. Shqetësime u ngritën edhe për kërkesat administrative të regjistrimit të vullnetarëve dhe për barrën e mundshme të regjimit të sanksioneve. Gjatë konsultimit, OJF-të paraqitën rekomandime të konsoliduara, të mbështetura nga ekspertiza ligjore, por jo të gjitha u pasqyruan në ligjin e miratuar.[90]

Në praktikë, gjatë vitit 2025, vullnetarizmi vijoi të ushtrohej edhe jashtë programeve të mbështetura nga shteti, përmes formave të organizuara dhe informale të angazhimit. Intervistat e zhvilluara me OJF-të nuk evidentuan raste të ndërhyrjes apo pengimit nga autoritetet publike të angazhimit të vullnetarëve, si dhe as raste të vendosjes së kërkesave për autorizim paraprak apo të aplikimit të sanksioneve lidhur me këtë angazhim. Megjithatë, mungesa e pengesave të tilla nuk u shoqërua me masa konkrete mbështetëse nga institucionet publike, si programe të posaçme, stimuj apo mekanizma të tjerë për promovimin dhe zhvillimin e vullnetarizmit.

2.3.3. Angazhimi Qytetar

Angazhimi qytetar promovohet në sistemin e arsimit parauniversitar përmes kuadrit ligjor dhe politikave arsimore që synojnë kultivimin e vlerave demokratike, qytetarisë aktive, pjesëmarrjes dhe përgjegjësisë sociale te nxënësit. Ligji nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar[91], përbën bazën kryesore ligjore për sistemin e arsimit parauniversitar. Edukimi qytetar është i integruar në kurrikulën zyrtare, ku programet përkatëse trajtojnë kulturën demokratike, të drejtat e njeriut, pjesëmarrjen dhe përgjegjësitë qytetare. Sistemi arsimor parashikon gjithashtu struktura përfaqësimi të nxënësve, përfshirë qeveritë e nxënësve, të cilat u mundësojnë atyre të marrin pjesë në jetën shkollore dhe në proceset vendimmarrëse.

Sipas përgjigjes së marrë nga Ministria e Arsimit, kuadri rregullator parashikon gjithashtu aktivitete plotësuese dhe jashtëshkollore në fushat sociale, kulturore, mjedisore dhe të lidhura me komunitetin, ku nxënësit marrin pjesë mbi baza vullnetare. Shkollat zbatojnë programe jashtë orarit të rregullt mësimor, përfshirë programet "Shkolla si Qendër Komunitare", "Bëjmë Detyrat e Shtëpisë", "Art, Zeje dhe Sport" dhe "Ekipet Sportive në Shkolla", si dhe aktivitete që lidhen me parandalimin e dhunës dhe bullizmit.

Kuadri rregullator mundëson gjithashtu bashkëpunimin ndërmjet shkollave dhe OJF-ve, megjithëse, sipas përgjigjes së Ministrisë, këto aktivitetet u nënshtrohen procedurave përkatëse të miratimit.

Në praktikë, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve arsimore dhe OJF-ve krijon mundësi shtesë për nxënësit që të marrin pjesë në aktivitete qytetare, sociale dhe të orientuara drejt komunitetit. Të dhënat nga intervistat dhe tregojnë se ky bashkëpunim ekziston, por mbetet kryesisht i bazuar në projekte. OJF-të raportuan gjithashtu se procedurat për marrjen e miratimit për zhvillimin e aktiviteteve në shkolla janë të zgjatura në kohë, duke kufizuar mundësitë për realizimin dhe vijimësinë e këtij bashkëpunimi.

[90] Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2026, "Komente dhe rekomandime për projektligjin "Për vullnetarizmin". I disponueshëm: https://resourcecentre.al/sq/komente-dhe-rekomandime-mbi-projektligjin-per-vullnetarizmin/

[91] Fletore Zyrtare 87/2012. Ligji Nr. 69, datë 21.6.2012, " Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë," i ndryshuar . I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2012/06/21/69

Fusha 3: **Marrëdhënia Shtet - OJF**

3.1. Kuadri Ligjor dhe Praktik për Bashkëpunim

3.1.1. **Strategjitë për Bashkëpunim**

Shqipëria aktualisht nuk ka një dokument strategjik qeveritar të posaçëm që të përcaktojë objektivat dhe drejtimet e politikave për zhvillimin e shoqërisë civile dhe bashkëpunimin me të. Kjo ndodh pavarësisht angazhimeve të përsëritura të qeverisë dhe faktit që hartimi i një kuadri të tillë është përfshirë si masë në Udhërrëfyesin për Funksionimin e Institucioneve Demokratike.[92] Udhërrëfyesi i dytë i Politikës Qeveritare drejt një Mjedisi më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019–2023 përfundoi me një nivel të ulët zbatimi të masave të parashikuara, gjë që tregon mungesë angazhimi dhe ndjekjeje të vazhdueshme institucionale. Hartimi i një udhërrëfyesi të tretë është parashikuar zyrtarisht, por më shumë se dy vjet pas përfundimit të të dytit nuk është miratuar asnjë dokument i ri dhe nuk ka të dhëna publike për hapa konkretë drejt hartimit të tij. Si rrjedhojë, mungesa e një dokumenti të përditësuar strategjik lë të papërcaktuara prioritetet dhe objektivat afatmesme të politikave për zhvillimin e shoqërisë civile dhe forcimin e bashkëpunimit të qeverisë me të.

I vetmi dokument politikash që përmban masa për krijimin e një mjedisi mundësues për organizatat e shoqërisë civile është Udhërrëfyesi për Funksionimin e Institucioneve Demokratike, i miratuar në vitin 2023 në kuadër të Grupkapitullit 1 të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Në praktikë, ka disa shembuj që dëshmojnë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve shtetërore dhe OJF-ve, veçanërisht në kuadër të konsultimeve për dokumentet strategjike, pjesëmarrjes në procesin e Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE), si dhe zhvillimit të aktiviteteve ose takimeve të përbashkëta. Informacioni i dhënë nga vetë ministritë lidhur me proceset e diskutimit dhe konsultimit pasqyron një qasje të pabarabartë dhe jo të qëndrueshme ndërmjet institucioneve. Ndërsa disa institucione raportuan zhvillimin e disa takimeve, këto duket se kanë shërbyer kryesisht si shkëmbime informacioni, më shumë sesa si procese të strukturuara konsultimi, me rezultate të qarta dhe mekanizma për ndjekjen e tyre. Në shumë raste, dokumentacioni i vënë në dispozicion ishte i pjesshëm dhe nuk ofronte një pasqyrë të plotë të procesit, pasi materialet mbështetëse, si procesverbalet, projektqëndrimet negociuese apo dokumentet e tjera të ndjekjes së procesit, nuk u nuk u ofruan në mënyrë të plotë. Në tërësi, informacioni i vënë në dispozicion evidenton mangësi të vazhdueshme në transparencë, dokumentim dhe raportim.

Të dhënat e mbledhura nga intervistat tregojnë se ky bashkëpunim ende nuk është i integruar në mënyrë sistematike në proceset e hartimit të politikave. Përfshirja e OJF-ve shpesh kufizohet në fazat e konsultimit, në vend që të përfshihen që në fazat e hershme të hartimit të politikave, ndërsa në disa raste vlerësohet si formale, me ndikim të kufizuar në vendimmarrjen përfundimtare. Afatet e shkurtra për konsultim, përfshirja selektive e aktorëve dhe reflektimi i pjesshëm i komenteve dëshmojnë elemente të një bashkëpunimi formal dhe jo të qenësishëm. Megjithëse janë ndërmarrë hapa për krijimin e strukturave dhe mekanizmave të përfshirjes, zbatimi i tyre në praktikë mbetet i kufizuar dhe jo gjithmonë efektiv.

[92] Fletore Zyrtare 168/2024, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.. 611, datë 2.10 2024, "Mbi aprovimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike". I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/10/02/611

Deri më tani, nuk është publikuar asnjë raport zyrtar mbi monitorimin dhe ecurinë e zbatimit të Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike. Në përgjigje të kërkesës për informacion, Ministria e Drejtësisë, si institucioni përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të tij, raportoi se gjatë periudhës së monitorimit janë realizuar 10 nga 14 masat strategjike të parashikuara. Megjithatë, Ministria nuk specifikoi se cilat masa ishin konsideruar të realizuara dhe nuk vuri në dispozicion dokumentacion apo të dhëna që të mbështesnin këtë raportim. Ndërkohë, monitorimi i pavarur i kryer nga Partnerët Shqipëri evidentoi se janë zbatuar vetëm dy nga 14 masat. Mospërputhja e konsiderueshme ndërmjet të dhënave të raportuara nga Ministria e Drejtësisë dhe gjetjeve të monitorimit të pavarur evidenton mungesën e transparencës dhe të dokumentacionit të nevojshëm për të verifikuar progresin real në zbatimin e Udhërrëfyesit.

Gjithashtu, mungojnë dëshmi që tregojnë se politikëbërësit përdorin në mënyrë sistematike të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse për të orientuar hartimin e politikave që lidhen me zhvillimin e shoqërisë civile. Gjithashtu, mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë nuk mundëson një vlerësim të plotë të pabarazive në përfaqësimin dhe drejtimin e organizatave, punësim, të ardhura, akses në financim dhe pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse. Në këtë kontekst, mungesa e të dhënave të strukturuara, të aksesueshme dhe të përditësuara kufizon mundësinë për të hartuar politika të bazuara në evidenca dhe për të zhvilluar një planifikim strategjik që pasqyron nevojat dhe sfidat reale të sektorit të shoqërisë civile.

3.1.2. Mekanizmat për Bashkëpunim

Mekanizmi kryesor institucional për bashkëpunimin ndërmjet qeverisë dhe sektorit të OJF-ve është Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), i krijuar në bazë të Ligjit nr. 119/2015, si një organ këshillimor kolegjial. Këshilli synon të lehtësojë bashkëpunimin institucional me OJF-të, të forcojë qeverisjen e mirë dhe të rrisë transparencën në vendimmarrjen publike.[93] I krijuar në vitin 2016, KKSHC-ja përbëhet nga 27 anëtarë: 13 përfaqësues të OJF-ve, 13 përfaqësues të institucioneve publike dhe një përfaqësues i Këshillit Kombëtar Ekonomik. Kjo përbërje siguron barazi numerike ndërmjet përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe atyre të institucioneve publike, duke krijuar një bazë formale për përfshirjen e OJF-ve në dialogun institucional.

Një tjetër strukturë ku organizatat e shoqërisë civile mund të kontribuojnë në diskutimin e politikave publike është Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian (KKIE) i krijuar në bazë të Ligjit nr. 15/2015, "Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit evropian", i ndryshuar.[94] Si struktura më e lartë këshillimore në nivel kombëtar për çështjet e integrimit evropian, KKIE-ja bashkon aktorë politikë, institucione publike, organizata të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë interesi për të diskutuar reformat dhe politikat që lidhen me procesin e integrimit në BE. Sipas Raportit Vjetor 2025 të Këshillit, përfaqësues të shoqërisë civile kanë marrë pjesë në veprimtarinë e tij, duke sjellë pikëpamjet dhe ekspertizën e tyre në diskutimet përkatëse.[95] Në këtë mënyrë, KKIE-ja përbën një kanal shtesë institucional për kontributin e OJF-ve në çështjet e integrimit evropian, brenda mandatit të tij këshillimor.

[93] Ligji nr. 119/2015, "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile", miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në fund të vitit 2015. I disponueshëm: https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2025/03/raporti-vjetor-2024-final.pdf. Faqja zyrtare e Këshillit: https://kkshc.gov.al/en/home/

[94] Parlamenti i Republikës së Shqipërisë. (2015). Ligji Nr. 15/2015, "Mbi rolin e Parlamentit në Procesin e Integrimit," i ndryshuar. I disponueshëm: https://www.parlament.al/struktura/cb7c3a17-5b45-42db-9d58-a866b432345a,

[95] Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian. (2026). Raporti Vjetor i Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian për vitin 2025. I disponueshëm: https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20260511093309061 2Raporti%20Vjetor%20i%20KKIE%202025.pdf

Pavarësisht rolit të tij formal, në praktikë KKSHC-ja përballet me kufizime që ndikojnë në funksionimin dhe efektivitetin e tij. Këshilli nuk ka buxhet të veçantë, pasi Ligji nr. 119/2015 parashikon që shpenzimet e veprimtarisë së tij të mbulohen nga buxheti i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), e cila ushtron edhe funksionin e Sekretariatit. [96] Sipas informacionit të dhënë nga Agjencia, këto shpenzime përfshijnë organizimin e mbledhjeve të Këshillit.

Një tjetër problematikë lidhet me vazhdimësinë e përfaqësimit institucional. Të dhënat për mbledhjet e fundit konfirmojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të disa ministrive dhe institucioneve qendrore, por nuk japin një pasqyrë të plotë të përfaqësimit të të gjitha institucioneve të parashikuara në ligj. Gjithashtu, dokumentacioni tregon se përfaqësuesit e institucioneve qeveritare kanë ndryshuar nga një mbledhje në tjetrën. Kjo e bën të vështirë vlerësimin e qëndrueshmërisë së angazhimit dhe të vazhdimësisë së përfaqësimit të institucioneve në punën e Këshillit.[97]

Veprimtaria e KKSHC-së ka qenë veçanërisht e kufizuar gjatë vitit 2025. Megjithëse ligji parashikon mbajtjen e të paktën tri mbledhjeve në vit, gjatë kësaj periudhe u zhvillua vetëm një, çka, sipas informacionit të raportuar, lidhet me zgjedhjet parlamentare dhe formimin e qeverisë së re.[98] Përtej frekuencës së ulët të takimeve, mungesa e ndjekjes së vazhdueshme të çështjeve të diskutuara kufizon mundësinë për të konsoliduar qëndrimet e OJF-ve dhe për t'i përcjellë ato në proceset e vendimmarrjes. Gjithashtu, mbetet e paqartë se në çfarë mase rekomandimet e Këshillit janë marrë në konsideratë nga institucionet dhe kanë gjetur pasqyrim në proceset e hartimit të politikave.[99]

Sipas Raportit Vjetor 2025 të KKIE-së, Këshilli ka ruajtur një nivel relativisht të rregullt të veprimtarisë gjatë periudhës së raportimit dhe ka vijuar të shërbejë si një platformë e strukturuar për dialogun mbi çështjet kryesore që lidhen me procesin e integrimit të Shqipërisë në BE. [100] Megjithatë, të dhënat e disponueshme nuk ofruan informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar se në çfarë mase kontributet dhe rekomandimet e OJF-ve, të paraqitura në kuadër të Këshillit janë reflektuar në proceset e hartimit të politikave.

3.2. Përfshirja në proceset politike dhe vendimmarrje

3.2.1. Standardet për Përfshirjen e OJF-ve

Kuadri ligjor në Shqipëri parashikon standarde dhe procedura për përfshirjen e OJF-ve në proceset e hartimit të politikave dhe vendimmarrjes, kryesisht përmes Ligjit nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik".[101] Ligji përcakton kërkesat procedurale që duhet të ndjekin autoritetet publike, duke përfshirë detyrimin për publikimin e projektakteve, garantimin e njoftimit transparent dhe vënien në dispozicion të një afati minimal prej 20 ditësh kalendarike për konsultim, gjatë të cilit palët e interesuara, përfshirë OJF-të, mund të paraqesin

[96] Fletore Zyrtare. 200/2015 Ligji Nr. 119/2015, "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile" fq. 13170–13174. I disponueshëm: https://qbz.gov.al/alfresco/webdav/FZ/2015/200/fz-2015-200.pdf?utm_source

[97] Më shumë informacion është i disponueshëm: https://kkshc.gov.al/mbledhjet-e-keshillit-procesverbale/

[98] Informacioni është marrë përmes kërkesës për informacion të Partnerëve Shqipëri.

[99] Më shumë informacion tek faqja e KKSHC-se. https://kkshc.gov.al/mbledhjet-e-keshillit-procesverbale/

[100] Këshilli Kombëtar i Integrimit Kombëtar. (2026).*"Raporti Vjetor 2025"*. I disponueshëm: https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20260511093309O612Raporti%20Vjetor%20i%20KKIE%202025.pdf

[101] Ligji Nr. 146/2014, datë 30.10. 2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik". I disponueshëm: https://idp.al/njkp/

komentet dhe sugjerimet e tyre. Gjithashtu, ligji i detyron institucionet të shqyrtojnë dhe të marrin në konsideratë çdo koment të marrë si dhe të japin përgjigje të argumentuara, duke shpjeguar pranimin ose mospranimin e tyre. Këto dispozita pasqyrojnë parimet kryesore të praktikës së mirë rregullatore, si pjesëmarrja, transparenca dhe llogaridhënia. Megjithatë, pavarësisht standardeve të përcaktuara në kuadrin ligjor, zbatimi i tyre në praktikë paraqet mangësi, veçanërisht për sa i përket cilësisë së proceseve të konsultimit, respektimit të afateve ligjore dhe marrjes në konsideratë të kontributeve të OJF-ve gjatë vendimmarrjes përfundimtare.

Krahas kuadrit të përgjithshëm për konsultimin publik, Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE) ofron një mekanizëm të posaçëm sektorial për zhvillimin e dialogut të strukturuar dhe përfshirjen e aktorëve të interesuar në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Nëpërmjet tryezave të diskutimit dhe konsultimit, OJF-të kanë mundësi të kontribuojnë me ekspertizën dhe rekomandimet e tyre për çështje që lidhen me fushat përkatëse të acquis të BE-së, përfshirë dokumentet strategjike dhe të planifikimit që lidhen me integrimin evropian, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me procesin e anëtarësimit.[102]

Në praktikë, sipas raportimit të qeverisë, gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 117 mbledhje të tryezave të diskutimit dhe konsultimit, duke shënuar një rritje prej 58,11% krahasuar me vitin 2024. Në këto mbledhje kanë marrë pjesë rreth 1,131 përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit, përfshirë 242 përfaqësues të OJF-ve, krahas përfaqësuesve të akademisë, biznesit, qeverisjes vendore, medias, shoqatave të punëmarrësve dhe ekspertëve të pavarur.[103] Informacioni i marrë drejtpërdrejt nga institucionet publike, i plotësuar me dokumentacionin e publikuar në faqet e tyre zyrtare, konfirmon funksionimin e mekanizmave të PPIE-së në disa prej fushave të negocimit. Mbledhjet janë shoqëruar, në nivele të ndryshme, me agjenda, lista pjesëmarrësish, procesverbale ose përmbledhje të përfundimeve të diskutimeve. Në disa raste, institucionet kanë raportuar se rekomandimet e dala nga këto konsultime kanë kontribuar në hartimin ose përmirësimin e politikave dhe dokumenteve strategjike, si dhe janë marrë në konsideratë në procesin e negociatave për anëtarësimin në BE.[104] Megjithatë, praktikat për dokumentimin e mbledhjeve, ndjekjen e rekomandimeve dhe marrjen e tyre në konsideratë ndryshojnë ndërmjet tryezave të PPIE-së, ndërsa informacioni i disponueshëm nuk ofron të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar nëse këto praktika zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë mekanizmin.

Gjithashtu, OJF-të janë angazhuar në ndjekjen e zbatimit dhe monitorimin e Agjendës së Reformave të Shqipërisë, në kuadër të Planit të Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor. Kuadri i Instrumentit për Reforma dhe Rritje parashikon përfshirjen e aktorëve të interesuar në monitorimin e zbatimit të reformave, duke përfshirë, sipas rastit, edhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe sektorit.[105] Angazhimi i shoqërisë civile është konkretizuar përmes monitorimit të pavarur të angazhimeve të reformave, zhvillimit të instrumenteve për

[102] Urdhër i Kryeministrit Nr. 113, datë 30.08. 2019, "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturave institucionale të Platformës së Partneritetit të Integrimit Evropian." I disponueshëm: https://www.kryeministria.al/platforma-e-partneritetit-per-integrimin-evropian/

[103] Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. (2026). Raporti mbi procesin e anëtarësimit dhe negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian për vitin 2025, seksioni 4.2, Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian. I disponueshëm: https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/648cb74b-9b57-426b-ae50-9937f443dc12

[104] Informacioni është siguruar nëpërmjet kërkesave për informacion të paraqitura nga Partnerët Shqipëri pranë institucioneve publike përgjegjëse dhe është plotësuar me dokumentacionin e publikuar mbi veprimtarinë e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian gjatë vitit 2025. Në përgjigjen e saj, Ministria e Brendshme raportoi se aktorët e interesuar kanë marrë pjesë aktivisht në diskutimet në kuadër të Kapitullit 24, se mbledhjet janë dokumentuar përmes agjendave, listave të pjesëmarrësve dhe procesverbaleve, si dhe se diskutimet dhe rekomandimet kanë kontribuar në dokumentet e politikave dhe ato strategjike dhe janë marrë në konsideratë në procesin e negociatave.

[105] Komisioni Evropian. (2024). Aneksi i Vendimit Zbatues të Komisionit për miratimin e Agjendave të Reformave dhe Programit Shumëvjeçar të Punës në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor. I disponueshëm: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/5b511ed0-b2ba-41c3-905c-74b95ae52c37_en

ndjekjen e progresit dhe organizimit të dialogut shumëpalësh mbi sfidat dhe prioritetet e zbatimit të tyre.[106] Këto iniciativa krijojnë mundësi shtesë për OJF-të që të kontribuojnë me evidenca, ekspertizë dhe rekomandime, si dhe të forcojnë mbikëqyrjen publike të progresit në zbatimin e Agjendës së Reformave. Megjithatë, përfshirja e shoqërisë civile në këtë proces mbetet e kufizuar dhe kontributi i saj realizohet kryesisht përmes nismave të pavarura të monitorimit dhe dialogut.

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA)[107] ofron module trajnimi për nëpunësit civilë mbi konsultimin publik, të drejtën për informim, buxhetimin me pjesëmarrje dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Këto module synojnë të forcojnë kapacitetet institucionale në fushën e transparencës, vendimmarrjes gjithëpërfshirëse dhe integrimit të perspektivës gjinore në planifikimin e financave publike dhe ofrimin e shërbimeve. Megjithatë, oferta e trajnimeve nuk përfshin programe të posaçme për përfshirjen e OJF-ve në proceset institucionale.

Intervistat e thelluara me OJF-të tregojnë se informacioni dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion gjatë proceseve të konsultimit nuk janë gjithmonë të plota dhe të mjaftueshme për t'u mundësuar organizatave të japin komente dhe rekomandime të argumentuara. Në disa raste, projektaktet vihen në dispozicion pa të gjithë dokumentacionin shoqërues të nevojshëm për shqyrtimin e tyre, siç janë vlerësimet e ndikimit, ose publikohen në një fazë të vonë të procesit, duke kufizuar kohën në dispozicion të OJF-ve për të analizuar përmbajtjen dhe për të paraqitur komente. Gjithashtu, janë evidentuar raste kur institucionet nuk i publikojnë projektaktet përpara ose gjatë procesit të konsultimit publik. Kjo cenon transparencën dhe kufizon mundësinë e OJF-ve për të paraqitur komente të argumentuara, në kohën e duhur. Në tërësi, këto problematika tregojnë se aksesi në informacion të plotë dhe në kohë nuk garantohet në mënyrë të qëndrueshme, megjithëse përbën një kusht të domosdoshëm për pjesëmarrje efektive në proceset e konsultimit.

Raportet përmbledhëse pas përfundimit të proceseve të konsultimit publik nuk publikohen në mënyrë të rregullt dhe, në rastet kur hartohen, cilësia dhe plotësia e tyre ndryshojnë nga një institucion në tjetrin. Në shumë raste, rezultatet e konsultimeve publikohen pa dhënë informacion të mjaftueshëm mbi kontributet e marra dhe mënyrën se si janë trajtuar komentet e paraqitura. Gjithashtu, përfshirja e listës së OJF-ve pjesëmarrëse nuk është një praktikë sistematike, ndërsa raportet e konsultimit rrallë përmbajnë shpjegime të qarta nëse rekomandimet janë pranuar apo refuzuar dhe arsyet për mosreflektimin e propozimeve të caktuara. Gjetjet nga intervistat sugjerojnë gjithashtu se një pjesë e sugjerimeve dhe komenteve nuk janë marrë fare në shqyrtim gjatë proceseve të konsultimit, duke evidentuar mangësi në transparencë, llogaridhënie dhe marrjen në konsideratë të kontributeve të aktorëve të interesuar. Në nivel vendor, pothuajse të gjitha bashkitë që iu përgjigjën kërkesës për informacion raportuan se kishin zhvilluar konsultime publike, por pjesëmarrja e OJF-ve në këto procese rezultoi përgjithësisht e ulët ose nuk u dokumentua në mënyrë që të mund të verifikohej. [108]

[106] Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (2025). *Reform Tracker: Albania*. I disponueshëm: https://cdinstitute.eu/scoreboard-albania/; Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. "*Reform Agjenda në Shqipëri– Mobilizimi i Shoqërisë Civile*". I disponueshëm: https://idmalbania.org/news-cpt/reform-agenda-in-albania-mobilizing-civil-society/

[107] Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e Shkollës Shqiptare për Administratën Publike. I disponueshëm: www.aspa.gov.al

[108] Në nivel vendor, pothuajse të gjitha bashkitë që paraqitën përgjigje raportuan se kishin zhvilluar konsultime publike, por pjesëmarrja e OJF-ve mbeti e ulët ose e paverifikueshme në shumicën e rasteve. Bashkia Lushnjë spikat si shembulli i praktikës më të mirë, me 28 konsultime, pjesëmarrjen e 4 OJF-ve dhe konsultimin e 92% të projektakteve. Bashkia Durrës zhvilloi 27 dëgjesa publike, por nuk specifikoi numrin e OJF-ve pjesëmarrëse. Aktivitet konsultues u evidentua edhe në bashkitë Rrogozhinë (14 konsultime, 50% e të cilave me pjesëmarrjen e shoqërisë civile), Bulqizë (14 konsultime, me pjesëmarrje rreth 10%), Maliq (13 konsultime, me pjesëmarrjen e 4 OJF-ve), Mirditë (10 konsultime, me pjesëmarrjen e 3 OJF-ve) dhe Dibër (10 konsultime, me pjesëmarrje 10%). Në të kundërt, 12 konsultimet e zhvilluara nga Bashkia Mallakastër nuk përfshinë asnjë OJF. Disa bashki, përfshirë Tepelenën, Prrenjasin, Poliçanin, Shijakun, Skraparin dhe Kuçovën, zhvilluan konsultime pa pjesëmarrjen e OJF-ve. Ndërsa bashkitë Libohovë, Finiq, Konispol, Patos dhe Pogradec raportuan se nuk kishin zhvilluar asnjë konsultim, duke

3.2.2. Aksesi në Draft Regulloret

Kuadri ligjor për konsultimin publik detyron institucionet publike të publikojnë projektligjet dhe strategjitë në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Aksesi në informacion rregullohet nga Ligji nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, [109] i cili përcakton procedura, afate dhe përjashtime të qarta. Megjithatë, zbatimi i këtij kuadri mbetet i paqëndrueshëm, pasi përgjigjet ndaj kërkesave për informacion nuk jepen gjithmonë brenda afateve të përcaktuara, ndërsa dokumentacioni shpesh vihet në dispozicion në formate të skanuara ose të paeditueshme, çka vështirëson aksesin, përpunimin dhe përdorimin e informacionit. Për të forcuar transparencën proaktive, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miratoi Urdhrin nr. 280/2025[110] dhe Urdhrin nr..281/2025.[111] Ky i fundit parashikon një seksion të posaçëm për veprimtarinë e Këshillave Bashkiakë dhe shtrin zbatimin e programit model edhe te Këshillat e Qarqeve. Të gjitha autoritetet publike duhet t'i zbatojnë këto modele deri më 31 mars 2026. Kuadri ligjor parashikon gjithashtu sanksione në rastet e mosrespektimit të detyrimeve.

Në praktikë, sipas raportit të Kuvendit, gjatë periudhës janar–korrik 2025, komisionet parlamentare shqyrtuan 159 amendamente, nga të cilat tetë ishin propozuar nga OJF. Megjithatë, asnjë prej këtyre tetë amendamenteve nuk rezulton të jetë miratuar.[112] Bazuar në të njëtin raport, Kuvendi vijoi gjithashtu përdorimin e platformës së tij online të konsultimit publik, përmes së cilës u konsultuan 39 dokumente: 16 projektligje, 20 raporte të institucioneve kushtetuese ose të krijuara me ligj, dy dokumente administrative dhe një projektstrategji. Sipas raportit, platforma e konsultimit u përmirësua më tej, duke marrë parasysh sugjerimet e shoqërisë civile. Ndër funksionalitetet e reja përfshihen mundësia që përdoruesit të ndjekin nëse komentet e tyre janë pranuar apo refuzuar, si dhe të marrin njoftime për afatet e konsultimit. Megjithatë, të dhënat e disponueshme ofrojnë informacion të kufizuar mbi shkallën në të cilën kontributet e OJF-ve reflektohen në mënyrë thelbësore në versionet përfundimtare të akteve ligjore dhe dokumenteve të politikave publike.

Në nivel qeverie, Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (https://konsultimipublik.gov.al/) shërben si platforma kryesore për publikimin e projektakteve dhe projektstrategjive, si dhe për mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve nga publiku.[113] Të dhënat e publikuara në platformë tregojnë se gjatë vitit 2025 janë hapur 74 procese konsultimi publik nga 11 ministri.

Megjithëse kuadri ligjor dhe institucional për konsultimin publik është i konsoliduar, vijojnë të evidentohen problematika lidhur me cilësinë dhe efektivitetin e proceseve të konsultimit. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2025 evidenton mungesën e konsultimeve publike efektive si një sfidë të vazhdueshme. Raporti

reflektuar mungesë të theksuar transparence. Praktikat e njoftimit gjithashtu ndryshonin nga një bashki në tjetrën: Bashkia Pustec përdorte vetëm faqen e saj zyrtare, ndërsa Bashkia Kukës përdorte rrjetet sociale dhe mediat lokale. Mungesa e njoftimit të drejtpërdrejtë të OJF-ve mund të shpjegojë, të paktën pjesërisht, nivelin e ulët të pjesëmarrjes së tyre në këto procese.

[109] Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit," i ndryshuar. I disponueshëm: https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Ligj-nr.119-date-18.9.2014_ndryshuar.pdf

[110] Urdhri Nr. 280, datë 20.12.2025, " Për miratimin e programit model të transparencës për autoritetet publike". I disponueshëm: https://idp.al/wp-content/uploads/2026/01/Urdher-nr.-280-miratimi-Programi-model-i-transparences-per-autoritetet-publike.pdf

[111] Urdhri Nr. 281/2025, datë 30.12.2025 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore". I disponueshëm: https://idp.al/wp-content/uploads/2026/01/Urdher-nr.-281-miratimi-Programi-model-i-transparences-per-Njesite-e-Vetegeverisjes-Vendore.pdf

[112] Parlamenti i Shqipërisë. (2025). Raporti i Shërbimit të Komisioneve Parlamentare, janar–korrik 2025. I disponueshëm: https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20250807081850822Raport%20She%CC%88rbimi%20i%20Komisioneve%20Parlamentare%2

[113] Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e platformës qeveritare të konsultimit publik. I disponueshëm: https://konsultimipublik.gov.al/

thekson nevojën për përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar kontrollin e cilësisë së proceseve të konsultimit, për të garantuar ndjekjen e duhur të komenteve dhe rekomandimeve të paraqitura, si dhe për të nxitur pjesëmarrjen e palëve të interesit, veçanërisht shoqërisë civile.[114]

Në kuadër të këtij raporti, bashkitë shënuan një normë më të lartë përgjigjeje ndaj kërkesave për informacion sesa ministritë. Konkretisht, 41 nga 61 bashki iu përgjigjën kërkesave të paraqitura, duke shënuar një normë përgjigjeje prej rreth 67%. Në nivel qendror, vetëm 8 nga 17 ministri kthyen përgjigje, ose rreth 47% e tyre. Megjithatë, këto shifra nuk pasqyrojnë plotësisht nivelin e përmbushjes së kërkesave për informacion. Një pjesë e përgjigjeve të marra, si nga bashkitë, ashtu edhe nga ministritë, nuk adresonin kërkesat e paraqitura ose i trajtonin ato vetëm pjesërisht. Për rrjedhojë, përqindja e përgjigjeve që ofruan informacion të plotë dhe përmbajtësor ishte më e ulët se norma e përgjithshme e përgjigjeve të marra.

Tabela 2: Ankesat e shqyrtuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Kategoria	Institucione Qendrore	NJësitë e Vetëqeverisjes Vendore	Autoritetet e tjera	Totali
Ankesat e marra gjatë 2025	385	293	183	861
Ankesat e marra nga OJF-të	0	26	61	87
Ankesat e marra gjatë 2024	—	—	—	36
Totali i ankesave të marra gjatë 2025	—	—	—	897

Sipas përgjigjes zyrtare të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në 69 raste institucionet publike vunë në dispozicion informacionin e kërkuar pas ndërhyrjes së Komisionerit, në vijim të ankesave të paraqitura nga OJF-të. Në tre raste të tjera, Komisioneri nxori vendime formale, duke pranuar dy ankesa dhe rrëzuar një. Këto të dhëna tregojnë se në shumicën e rasteve informacioni është vënë në dispozicion pas ndërhyrjes së Komisionerit, pa qenë e nevojshme nxjerrja e një vendimi formal. Megjithatë, mungesa e informacionit mbi ecurinë dhe rezultatin e ankesave të tjera nuk lejon të vlerësohet plotësisht se si janë trajtuar dhe zgjidhur të gjitha ankesat e paraqitura nga OJF-të.

3.2.3. Pjesëmarrja në Organet Ndërsektoriale

Kuadri ligjor dhe institucional parashikon përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes përmes mekanizmave të strukturuar, siç janë tryezat e diskutimit dhe konsultimit të ngritura në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE), si dhe grupet e tjera të punës sektoriale të koordinuara nga ministritë e linjës. PPIE u krijua me Urdhrin e Kryeministrit nr. 113, datë 30.08.2019, dhe përbëhet nga dy nivele: Bordi i PPIE-së dhe 33 tryeza diskutimi dhe konsultimi, nga një për secilin kapitull të acquis të Bashkimit Evropian që është në proces negocimi. [115] Secila tryezë drejtohet nga

[114] Komisioni Evropian. (2025). *Raporti për Shqipërinë 2025.* I disponueshëm: https://enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2025_en
[115] Urdhri i Kryeministrit nr. 113, datë 30.08.2019, "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian". Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, "Procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në BE". I

negociatori përgjegjës për kapitullin përkatës. [116] Këto grupe ndërinstitucionale të punës janë ngritur për të 33 kapitujt e acquis të BE-së dhe përbëhen nga përfaqësues të institucioneve shtetërore përgjegjëse për secilin kapitull, si dhe aktorë të tjerë të interesuar, përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të grupeve të tjera të interesit, në përputhje me strukturën dhe fushën e përgjegjësisë së secilit kapitull. Ky mekanizëm synon të lehtësojë dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve publike dhe aktorëve të përfshirë në procesin e integrimit evropian.

Kuadri përcakton një procedurë aplikimi për anëtarësimin në tryezat e diskutimit dhe konsultimit të PPIE-së. Aplikantët duhet të paraqesin një letër interesi dhe një CV që dëshmon ekspertizën ose interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në tryezën përkatëse. Aplikimet vlerësohen nga grupet ndërinstitucionale të punës gjatë krijimit të tryezave dhe, për kërkesat e mëvonshme për anëtarësim, nga drejtuesit e tyre. Çdo refuzim duhet të jetë i arsyetuar.

Bazuar në përgjigjet e marra nga ministritë, rezulton se praktikat institucionale ndryshojnë: disa ministri publikojnë thirrje të hapura, ndërsa të tjera mbështeten në bashkëpunimin e drejtpërdrejtë me organizatat. Kjo mungesë e një praktike të njëtrajtshme ngre shqetësime lidhur me transparencën, mundësitë e barabarta për pjesëmarrje, si dhe zbatimin e qëndrueshëm të procedurës së përcaktuar për anëtarësim.

Nga intervistat me ekspertët nuk rezultuan të dhëna që OJF-të të jenë përballur me kontroll shtetëror, sanksione, inspektime apo forma presioni si pasojë e shprehjes së qëndrimeve kritike gjatë pjesëmarrjes në këto struktura këshillimore dhe grupe pune. Sipas ekspertëve të konsultuar, përfaqësuesit e OJF-ve kanë pasur përgjithësisht lirinë të shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre pa u përballur me pasoja apo masa ndëshkuese.

Sa i përket përfshirjes së OJF-ve në nivel vendor, përfaqësuesit e tyre zakonisht përzgjidhen nga bashkitë në bazë të bashkëpunimit të mëparshëm ose të ekspertizës që lidhet me tematikën që do të diskutohet, dhe jo përmes një procesi formal dhe publik përzgjedhjeje.

Nuk u identifikuan kufizime që pjesëmarrja në këto struktura këshillimore të pengojë aftësinë e OJF-ve për të zhvilluar veprimtari advokuese. Organizatat mbeten të lira të shprehin publikisht qëndrimet e tyre, të angazhohen në media, të krijojnë koalicione, të ndërmarrin nisma për mbledhjen e firmave për peticione dhe të përdorin forma të tjera advokimi, krahas pjesëmarrjes së tyre në mekanizmat formalë të konsultimit.

3.3. Bashkëpunimi në Sigurimin e Shërbimeve

3.3.1. Përfshirja e OJF-ve në ofrimin e shërbimeve dhe procedurat e kontraktimit

Referuar ofrimit të shërbimeve dhe konkurrimin për kontrata publike, Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka përfshirë një kapitull të posaçëm që rregullon kontratat publike për shërbimet sociale dhe

disponueshëm: https://amf.gov.al/pdf/publikime/Urdher-Nr.-113-date-30.08.2019-Per-format-e-pjesemarrjes-funksionimin-dhe-strukturen-institucionale-te-platformes-se-partneritetit-per-integrimin-Evropian.pdf

[116] Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, “Grupet Ndërinstitucionale të Punës”. I disponueshëm: https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/en/strukturat/grupet-nderinstitucionale-te-punes/

shërbime të tjera specifike. [117] Ligji i kushton rëndësi të veçantë kritereve të cilësisë në prokurimin e shërbimeve sociale, si dhe parashikon mundësinë që pjesëmarrja në procedurat për kontrata të caktuara për shërbime shëndetësore, sociale dhe kulturore t'u rezervohet organizatave që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 102 dhe 103.

Në këtë kontekst, Ligji nr. 92/2025 "Për kujdesin alternativ familjar në Republikën e Shqipërisë" [118] zgjeron më tej mundësitë për përfshirjen e OJF-ve në ofrimin e shërbimeve sociale, duke njohur shprehimisht rolin e tyre në kujdesin alternativ me bazë familjen. Sipas nenit 26, OJF-të e licencuara, që kanë përvojë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe ofrimit të shërbimeve sociale, mund të bashkëpunojnë me bashkitë për të mbështetur fëmijët dhe familjet e përfshira në kujdesin alternativ, të ofrojnë trajnime dhe këshillim për familjet kujdestare, si dhe të kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të bashkive në këtë fushë. Ligji gjithashtu kërkon që bashkitë të nxisin bashkëpunimin me OJF-të dhe kontributin e tyre në sistemin e kujdesit alternativ me bazë familjen. Megjithatë, kriteret dhe procedurat e detajuara për përfshirjen e OJF-ve do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo do të thotë se mundësitë konkrete të OJF-ve për të përfituar dhe për t'u përfshirë në këto mekanizma do të varen nga miratimi dhe zbatimi i akteve nënligjore përkatëse.

Kuadri ligjor parashikon gjithashtu një bazë formale për prokurimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike përmes procedurave të prokurimit publik. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 768, datë 15.12.2021, i ndryshuar, përcakton kategoritë e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, përfshirë ato për të cilat pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik mund t'u rezervohet organizatave të caktuara, si dhe rregullat e detajuara që rregullojnë këto procedura. Agjencia e Prokurimit Publik sqaroi, gjatë zhvillimit të këtyre procedurave, autoritetet kontraktore duhet t'u referohen kodeve specifike të shërbimeve të përcaktuara në anekset e këtij vendimi. Njoftimet e procedurave të prokurimit dhe kontratat e lidhura publikohen nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit publik dhe buletinit të prokurimit publik, duke garantuar transparencën formale të procedurave individuale.

Aksesi i OJF-ve në ofrimin e shërbimeve sociale lidhet gjithashtu me kërkesat e licencimit specifike për sektorin. OJF-të që ushtrojnë veprimtari për të cilat kërkohet licencim duhet të pajisen me licencën përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, informacioni i konsoliduar dhe publik mbi numrin e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale mbetet i kufizuar. Gjetjet nga intervistat e thelluara të zhvilluara me OJF-të tregojnë se, ndonëse kërkesat dhe procedurat e licencimit janë të përcaktuara në kuadrin ligjor, në praktikë organizatat mund të përballen me vështirësi administrative dhe procedurale, veçanërisht ato me kapacitete të kufizuara organizative.

Përgjigjja e Agjencisë së Prokurimit Publik sqaron se, ndërsa procedurat e prokurimit dhe operatorët ekonomikë fitues publikohen përmes mjeteve të të dhënave të hapura dhe Buletinit të Prokurimit Publik, Agjencia nuk administron dokumentacionin e plotë të procedurave të zhvilluara nga autoritetet kontraktore individuale. Për këtë arsye, ajo nuk disponon të dhëna të konsoliduara mbi procedurat e rezervuara, buxhetet përkatëse apo pjesëmarrjen e subjekteve jofitimprurëse. Si rrjedhojë, informacioni i disponueshëm nuk mundëson një vlerësim të plotë të pjesëmarrjes së OJF-ve në këto procedura dhe të mundësive të tyre për të konkurruar për kontrata publike në fushën e ofrimit të shërbimeve.

[117] Fletore Zyrtare nr. 30/2021. Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenet 100–103. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/12/23/162

[118] Fletorja Zyrtare nr. 9/2026, Ligji nr. 92/2025, datë 18.12.2025, "Për kujdesin alternativ familjar në Republikën e Shqipërisë". I disponueshëm: https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2026/02/Ligji-92-2025.pdf

Në vitin 2025, nga 41 bashkitë që iu përgjigjën kërkesës për informacion, vetëm tri prej tyre dhanë të dhëna mbi fondet e akorduara për OJF-të për ofrimin e shërbimeve sociale, të paraqitura në Tabelën 3. Financimi i raportuar ndryshonte ndjeshëm, ku Bashkia Shkodër raportoi fondin më të lartë. Mbështetja ishte orientuar kryesisht drejt familjeve dhe grupeve të tjera në nevojë, personave të mbijetuar nga dhuna në familje dhe të moshuarve. Këto të dhëna tregojnë se financimi i drejtpërdrejtë nga bashkitë i shërbimeve sociale të ofruara nga OJF-të mbetet i kufizuar në nivel vendor.

Tabela 3: Ofrimi i shërbimeve nga bashkitë për vitin financiar 2025

Bashkia	OJF fituese	Shërbimi total i mbështetuar	Shuma totale e dizbursuar
Shkodër	2 OJF	Shërbime sociale për familjet dhe grupet në nevojë	44,500,000 lekë (përafërsisht 464,000 euro)
Vlorë	1 OJF	Strehim, siguri dhe shërbime të lidhura për grupet në nevojë	3,800,000 lekë (përafërsisht EUR 39,600)
Lezhë	2 OJF	Mbështetje për viktimat e dhunës në familje dhe të moshuarit	At least 600,000 lekë (përafërsisht EUR 6,250)

3.3.2. Financimi dhe monitorimi e vlerësimi i shërbimeve të ofruara nga OJF-të

Kuadri ligjor nuk përcakton pengesa formale që i ndalojnë OJF-të të përfitojnë financim publik për ofrimin e shërbimeve përmes procedurave të prokurimit publik, granteve apo mekanizmave të tjerë të kontraktimit. Në parim, OJF-të lejohen të marrin pjesë në mekanizmat përmes të cilëve shteti delegon ofrimin e shërbimeve te ofrues të jashtëm. Kuadri parashikon gjithashtu mundësinë e monitorimit të shpenzimeve financiare dhe, deri në një masë të caktuar, të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga ofruesit. Gjithashtu, ai mundëson mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve përmes rregullave dhe standardeve përkatëse që zbatohen në sektorët përkatës.

Megjithatë, mungesa e pengesave ligjore nuk përkthehet domosdoshmërisht në akses efektiv në praktikë. Kuadri ligjor ofron mundësi të kufizuara për financimin e shërbimeve të ofruara nga OJF-të dhe nuk garanton financim të mjaftueshëm, të parashikueshëm apo shumëvjeçar. Në praktikë, ai nuk mbështet në mënyrë sistematike marrëdhënie kontraktuale afatgjata apo financim të qëndrueshëm për OJF-të që ofrojnë shërbime.

Intervistat me organizatat që ofrojnë shërbime sociale evidentojnë një hendek ndërmjet mundësive që parashikon kuadri ligjor dhe zbatimit të tyre në praktikë. Ndonëse legjislacioni u mundëson OJF-ve të përfitojnë financim publik për ofrimin e shërbimeve, sipas organizatave të intervistuara, mbështetja financiare nga shteti për këtë qëllim mbetet shumë e kufizuar . Si rezultat, organizatat hasin vështirësi në garantimin e vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimeve, ndërsa fondet e disponueshme janë përgjithësisht të pamjaftueshme për të mbuluar kostot reale të ofrimit të tyre, përfshirë shpenzimet administrative dhe kostot e funksionimit institucional. Kjo krijon një varësi të konsiderueshme nga donatorët e huaj dhe mbështetja e bazuar në projekte, duke cenuar parashikueshmërinë dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të shërbimeve sociale të ofruara nga OJF-të..

Kufizimet në financimin publik ndikojnë gjithashtu në mundësitë për monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve sociale të ofruara nga OJF-të. Të dhënat e mbledhura dhe intervistat me organizatat sugjerojnë se monitorimi

sistematik i performancës së ofruesve, si dhe vlerësimi i cilësisë dhe ndikimit të shërbimeve nga institucionet publike, mbeten të kufizuara. Sipas organizatave të intervistuara, në mungesë të financimit publik dhe të marrëdhënieve kontraktuale me institucionet shtetërore, këto procese nuk janë konsoliduar si praktika të rregullta, të strukturuara dhe të dokumentuara publikisht.

Bibliografia

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, 2026 “Raporti Vjetor 2025”, fq. 29. I disponueshëm: https://aapsk.gov.al/wp-content/uploads/2026/02/Raporti-2025-Final.pdf.

Agjencia Kombëtare e Rinisë, 2025, “Nënshkrimi i kontratave me Organizatat Fituese të thirrjes V,” I disponueshëm: https://rinia.gov.al/nenshkrimi-i-kontratave-me-organizatat-fituese-te-thirrjes-v/?utm_source

Agjencia Kombëtare e Rinisë, 2025, “Sesion Informimi Online për Thirrjen Nr. V për Projekt Propozime të organizatave dhe të rinjtë”. I disponueshëm: https://rinia.gov.al/en/sesionet-informuese-online-per-thirrjen-publike-nr-v-per-projekt-propozime-per-organizatat-rinore-dhe-per-te-rinjte/?utm_source

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, 2025 “Ditari Nr. 32, Janar - Qershor 2025”, fq. 5–6. I disponueshëm: https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2025/07/AMSHC-Ditar_janar-qershor-2025.pdf?utm_source

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Thirrja nr. 18 për Projekt-Propozime, dokumentacioni i aplikimit, përfshirë Deklaratën e Konfliktit të Interesit. I disponueshëm: https://amshc.gov.al/thirrje-nr-18-per-projekt-propozime-13-maj-2025-deri-13-qershor-2025/?utm_source

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Thirrja nr. 18 për Projekt-Propozime, dokumentacioni i aplikimit, përfshirë Deklaratën e Konfliktit të Interesit. I disponueshëm: https://amshc.gov.al/thirrje-nr-18-per-projekt-propozime-13-maj-2025-deri-13-qershor-2025/?utm_source

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, 2026 *“Raporti Vjetor 2025”.* I disponueshëm: https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2026/02/raporti-Vjetor-i-veprimtarise-AMSHC-per-vitin-2025_compressed.pdf?utm_source

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030 dhe Plani i Veprimit 2025–2027. E disponueshme: https://aksk.gov.al/en/the-national-cyber-security-strategy-2025-2030-and-action-plan-are-approved

Civil Rights Defenders, 2026, “Raporti për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Shqipëri – 2025”. I disponueshëm: https://acqj.al/wp-content/uploads/2026/05/HRD-Albania-2025-updated.pdf?utm_source

INSTAT, 2026 “Regjistrat e Biznesit”. I disponueshëm: https://www.instat.gov.al/media/2hololz3/tab-1-nj%C3%ABsi-ligjore-aktive-sipas-form%C3%ABs-ligjore.xlsx

Këshilli Evropian. (2025). *Takimi i shtatë i Konferencës së Anëtarësimit me Shqipërinë në nivel ministror, 17 nëntor 2025*. Shih gjithashtu: Komisioni Evropian. (2025). *Raporti për Shqipërinë 2025*, f. 3–4 dhe 93–95. I disponueshëm: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf

Komisioni Evropian. (2025). *Raporti për Shqipërinë 2025*, Dokument pune i shërbimeve të Komisionit, SWD (2025) 750 final. I disponueshëm:

https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf&utm_source

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, (2018), "*Standardet Kombëtare të Kontabilitetit për OJF-të"*. I disponueshëm: https://kkk.gov.al/udhezuesi-per-hartimin-e-raportit-jofinanciar/

Këshilli Kombëtar i Integrimit Kombëtar. (2026).*"Raporti Vjetor 2025"*. I disponueshëm: https://kuvendiwebfiles.blob.core.windoës.net/webfiles/20260511093309061 2Raporti%20Vjetor%20i%20KKIE%202025.pdf

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. (2026). Raporti mbi procesin e anëtarësimit dhe negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian për vitin 2025, seksioni 4.2, Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian. I disponueshëm: https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/648cb74b-9b57-426b-ae50-9937f443dc12

Komisioni Evropian. (2024). Aneksi i Vendimit Zbatues të Komisionit për miratimin e Agjendave të Reformave dhe Programit Shumëvjeçar të Punës në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor. I disponueshëm: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/5b511ed0-b2ba-41c3-905c-74b95ae52c37_en

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. I disponueshëm: https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd

Fletore Zyrtare 28/2001, Ligji Nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar. I disponueshëm: https://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/05/07/8788

Fletore Zyrtare 121/2021, Ligji 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse". I disponueshëm: https://qbz.gov.al/share/w3e6ZV2nR76t_BQFHt-CXw

Fletore Zyrtare 62/2023. I disponueshëm: https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/11/20/62/54732040-bf13-412e-8d47-09b1736264d6

Fletorja Zyrtare nr. 149/2022, ligji nr. 6/2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 112/2020 'Për regjistrin e pronarëve përfitues', të ndryshuar". I disponueshëm: https://qbz.gov.al/preview/caaa4106-aab1-44bb-a34b-1ada78851423/cons/20220216

Fletore Zyrtare Nr. 96/2024, Ligji Nr. 54/2024, datë 30.5.2024, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë". E disponueshme:https://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/05/30/54/b6aa032c-a862-4bc3-816d-5cf7c600ac9e;q=LIGJ%20Nr.%2054%2F2024%20P%C3%8BR%20KOMUNIKIMET%20ELEKTRONIKE%20N%C3%8B%20REPUBLIK%C3%8BN%20E%20SHQIP%C3%8BRIS%C3%8B

Fletore Zyrtare 9/2025, Ligji Nr. 124/2024, datë 19.12.2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale". E disponueshme: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/12/19/124

Fletore Zyrtare nr. 37/2009, Ligji nr. 10093, datë 9.03 2009, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile". I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2009/03/09/10093

Fletore Zyrtare nr. 37/2009, Ligji nr. 10093, datë 9.3.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2009/03/09/10093;

Fletore Zyrtare 168/2024, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 611, datë 2.10.2024, “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/10/02/611

Fletore Zyrtare 168/2024, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 611, datë 2.10.2024, “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/10/02/611

Fletore Zyrtare 168/2024, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 611, datë 2.10.2024, “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/10/02/611

Fletore Zyrtare 31/ 2005, Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2005/04/07/9367

Fletore Zyrtare 97/2010, Ligji. Nr. 10296, date 8.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2010/07/08/10296

Fletore Zyrtare 186/2015, Ligji. Nr.112/2015, datë 15.10 2015, “Për inspektimin financiar publik”. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/10/15/112

Fletore Zyrtare 186/2015, Ligji. Nr.112/2015, datë 15.10 2015, “Për inspektimin financiar publik”. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/10/15/112

Fletore Zyrtare 166/2010, Ligji Nr. 10352, date 18.11.2010, “Mbi artin dhe kulturën”, as amended. Available at: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2010/11/18/10352

Fletore Zyrtare 99/2019, Ligji nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar. Available at: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2019/06/17/34

Fletore Zyrtare 201/2020. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 888, datë 11.11.2020 “Për përcaktimin e kritereve, metodave dhe procedurave të vlerësimit për dhënien në përdorim dhe tjetërsimin e pasurive të konfiskuara’. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/11/11/888

Fletore Zyrtare Nr. 130/2020, VKM. Nr 535, datë 8.07.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat e zbatimit të Programit të Punëve Publike Komunitare”, i ndryshuar”, i ndryshuar, fq. 7710, kapitulli III, para. 4. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/07/08/535

Fletore Zyrtare 15/2026. Ligji Nr. 94/2025 “Për vullnetarizmit”. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2025/12/18/94

Fletore Zyrtare 87/2012. Ligji Nr. 69, datë 21.6.2012, " Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë," i ndryshuar . I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2012/06/21/69

Fletore Zyrtare 168/2024, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.. 611, datë 2.10 2024, “Mbi aprovimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/10/02/611

Fletore Zyrtare. 200/2015 Ligji Nr. 119/2015, “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile” fq. 13170–13174. I disponueshëm: https://qbz.gov.al/alfresco/webdav/FZ/2015/200/fz-2015-200.pdf?utm_source

Fletore Zyrtare nr. 30/2021. Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 100–103. I disponueshëm: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/12/23/162

Fletorja Zyrtare nr. 9/2026, Ligji nr. 92/2025, datë 18.12.2025, “Për kujdesin alternativ familjar në Republikën e Shqipërisë”. I disponueshëm: https://www.sherbimisocial.gov.al/ëp-content/uploads/2026/02/Ligji-92-2025.pdf?utm_source

Ligji Nr. 25/2024 "Për Sigurinë Kibernetike", i disponueshëm në: https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/ligj-2024-03-21-25-5-1.pdf

Ligji. Nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”. I disponueshëm: https://asp.gov.al/wp-content/uploads/2025/08/Law-no.82-for-State-Police-26.7.2024-English.pdf

Ligji Nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” I disponueshëm: https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/04/Law-on-Protection-from-Discrimination-Albania.-2020.pdf

Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994, "Për sponsorizimet", i ndryshuar me Ligjin nr. 9807, datë 20.09.2007. I disponueshëm: https://portavendore.al/wp-content/uploads/2018/05/Ligji-nr.7892-date-21.12.1994-Per-sponsorizimet.pdf

Ligji Nr. 7961, date 12.07.1995, “Kodi i Punës I Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. I disponueshëm: https://qbz.gov.al/preview/c1c18a6c-5f3e-457d-b931-de505b3c7ed0?utm_source

Ligji nr. 119/2015, “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në fund të vitit 2015. I disponueshëm: https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2025/03/raporti-vjetor-2024-final.pdf. Faqja zyrtare e Këshillit: https://kkshc.gov.al/en/home/

Ligji Nr. 15/2015, “Mbi rolin e Parlamentit në Procesin e Integrimit,” i ndryshuar. I disponueshëm: https://www.parlament.al/struktura/cb7c3a17-5b45-42db-9d58-a866b432345a

Ligji Nr. 146/2014, datë 30.10. 2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik”. I disponueshëm: https://idp.al/njkp/

Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 265 dhe 266. I disponueshëm: https://qbz.gov.al/eli/ligj/1995/01/27/7895

Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit," i ndryshuar. I disponueshëm: https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Ligj-nr.119-date-18.9.2014_ndryshuar.pdf

Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë, “Smart City Albania”, 19 dhjetor 2025. I disponueshëm: https://mb.gov.al/en/newsroom/smart-city-albania/?utm_source

Ministria e Drejtësisë, “Lista me 14 OJF të autorizuara për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore”. I disponueshëm: https://www.drejtesia.gov.al/lista-e-ojf-ve-14-ojf-te-autorizuara-nga-ministri-i-drejtesise-per-ofrimin-e-sherbimit-te-ndihmes-juridike-paresore/?utm_source

Ministria e Drejtësisë, 2026, *"Raporti i Monitorimit 2025"*. I disponueshëm: https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2026/07/Raporti-i-Monitorimit-per-vitin-2025.pdf?utm_source

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, "Grupet Ndërinstitucionale të Punës". I disponueshëm: https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/en/strukturat/grupet-nderinstitucionale-te-punes/

Parlamenti i Shqipërisë. (2025). Raporti i Shërbimit të Komisioneve Parlamentare, janar–korrik 2025. I disponueshëm: https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20250807081850082 2Raport%20She%CC%88rbimi%20i%20Komisioneve%20Parlamentare%2

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. (2025). *Komente mbi projektligjin "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"*. I disponueshëm: https://www.partnersalbania.org/News/comments-on-the-draft-law-on-whistleblowing-and-whistleblower-protection/

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. (2025). *Komente dhe rekomandime mbi projektligjin "Për lobimin"*. I disponueshëm: https://www.partnersalbania.org/News/comments-and-recommendations-on-the-draft-law-on-lobbying/

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2026, Komente dhe rekomandime për projektligjin "Për donacionet dhe sponsorizimet". I disponueshëm: https://www.partnersalbania.org/News/comments-and-recommendations-on-the-draft-law-on-donations-and-sponsorships/

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2026, "Komente dhe Rekomandime për projekligjin "Për donacionet dhe sponsorizimet". I disponueshëm: https://www.partnersalbania.org/News/comments-and-recommendations-on-the-draft-law-on-donations-and-sponsorships/

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2026, "Philanthropy Magazine". I disponueshëm: https://www.partnersalbania.org/wp-content/uploads/2025/07/Philanthropy_Magazine_Ed10.pdf

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2026, "Komente dhe rekomandime për projektligjin "Për vullnetarizmin". I disponueshëm: https://resourcecentre.al/sq/komente-dhe-rekomandime-mbi-projektligjin-per-vullnetarizmin/?utm_source

Qendra Kombëtare e Biznesit (2026) *"Raporti Vjetor 2025*". I disponueshëm: https://qkb.gov.al/wp-content/uploads/2026/03/Raport-Vjetor-2025.pdf

Reporterë pa Kufij (2026), Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit 2025. I disponueshëm: https://rsf.org/en/country/albania

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese u publikua në Fletoren Zyrtare nr. 5/2024. I disponueshëm: https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/11/20/62/54732040-bf13-412e-8d47-09b1736264d6

Urdhër i Kryeministrit Nr. 113, datë 30.08. 2019, "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturave institucionale të Platformës së Partneritetit të Integrimit Evropian." I disponueshëm: https://www.kryeministria.al/platforma-e-partneritetit-per-integrimin-evropian/

Urdhri i Kryeministrit nr. 113, datë 30.08.2019, "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian". Ministria për Evropën dhe Punët e

Jashtme, “Procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në BE”. I disponueshëm: https://amf.gov.al/pdf/publikime/Urdher-Nr.-113-date-30.08.2019-Per-format-e-pjesemarrjes-funksionimin-dhe-strukturen-institucionale-te-platformes-se-partneritetit-per-integrimin-Evropian.pdf?utm_source

Urdhri Nr. 280, datë 20.12.2025, " Për miratimin e programit model të transparencës për autoritetet publike". I disponueshëm: https://idp.al/wp-content/uploads/2026/01/Urdher-nr.-280-miratimi-Programi-model-i-transparences-per-autoritetet-publike.pdf?utm_source

Urdhri Nr. 281/2025, datë 30.12.2025 “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”. I disponueshëm: https://idp.al/wp-content/uploads/2026/01/Urdher-nr.-281-miratimi-Programi-model-i-transparences-per-Njesite-e-Veteqeverisjes-Vendore.pdf

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 953, datë 29.12.2014 “Për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 92/2014”, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. I disponueshëm: https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=13683

Vendimi nr. 769, datë 15.7.2009, “Për miratimin e Statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. I disponueshëm: https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2026/04/vendim-2009-07-15-769-statuti-i-amshc.pdf?utm_source

Rrjeti për Fuqizimin e Grave në Shqipëri (AWEN), Gratë si Mbrojtëse të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri, 2025. I disponueshëm: https://awenetwork.org/media/682f2843bb7b1.pdf

Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (2025). *Republika e Shqipërisë: Zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025 — Raporti përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve*, f. 2–4 dhe 22–25. I disponueshëm: https://odihr.osce.org/sites/default/files/documents/official_documents/2026/05/ALB%20Parliamentary%202025%20Final%20Report_23.10.2025.pdf

Aneks

Kuadri dhe Metodologjia e Matricës së Monitorimit

Matrica e Monitorimit për Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile është një kuadër i detajuar teorik, i mbështetur në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe në praktikat rregullatore të vendeve evropiane dhe të Bashkimit Evropian. Kuadri është ndërtuar mbi tri fusha kryesore: **Garancitë Themelore Ligjore të Lirive; Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Viabilitetin Financiar të OJF-ve; dhe Marrëdhëniet ndërmjet Qeverisë dhe OJF-ve.** Secila prej këtyre fushave ndahet në nënfusha. Fushat shtjellohen përmes standardeve, të cilat specifikohen më tej nëpërmjet treguesve ligjorë dhe të praktikës. Për secilin tregues jepen udhëzime të qarta mbi strategjinë e mbledhjes së të dhënave që duhet të përdorin studiuesit në nivel vendi, duke përfshirë të dhënat e disponueshme publikisht, kërkesat për të drejtën e informimit, anketat, grupet e fokusit dhe intervistat, si dhe burimet dytësore përkatëse. Matrica e Monitorimit është një metodologji gjithëpërfshirëse, e zhvilluar në vitin 2013 dhe e rishikuar për herë të fundit në vitin 2023, e cila synon të vlerësojë mjedisin mundësues për OJF-të në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, në raport me standardet ndërkombëtare. Matrica funksionon përmes një cikli vjetor raportimi, i cili mundëson një vlerësim sistematik dhe të krahasueshëm në të gjithë rajonin dhe ndërmjet viteve. Kjo u mundëson aktorëve të ndjekin progresin ose regresin, të identifikojnë mangësitë dhe tendencat e reja, si dhe të përcaktojnë prioritetet për reforma. Hulumtimi synon të ofrojë të dhëna dhe prova mbi mjedisin mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile dhe të ndikojë në orientimin e mbështetjes së qeverive, Bashkimit Evropian dhe donatorëve të tjerë drejt zhvillimit më të qëndrueshëm dhe strategjik të sektorit. Në nivel kombëtar, gjetjet e Matricës së Monitorimit kanë shërbyer si bazë për hartimin e strategjive kombëtare për bashkëpunimin me sektorin dhe zhvillimin e tij, si dhe kanë mbështetur drejtpërdrejt hartimin e ligjeve të rëndësishme. Në nivel evropian, gjetjet e Matricës së Monitorimit janë përdorur në mënyrë të vazhdueshme në Raportet e Komisionit Evropian për Vendet, në kuadër të Paketës së Zgjerimit, si dhe, që prej vitit 2024, në Raportin për Sundimin e Ligjit.

Raporti i Matricës së Monitorimit bazohet në një analizë gjithëpërfshirëse të kuadrit ligjor, politikave dhe dokumenteve strategjike që rregullojnë mjedisin mundësues për OJF-të në Shqipëri gjatë vitit 2025, duke përfshirë gjithashtu zhvillimet përkatëse të vitit 2026. Gjatë procesit të kërkimit dokumentar u shqyrtuan ligjet, aktet nënligjore, strategjitë, planet e veprimit dhe raportet, të plotësuara me të dhëna mbi zbatimin e tyre në praktikë. Të dhënat parësore u mblodhën përmes tri diskutimeve në grupe fokusi me: (i) grupet informale dhe të paregjistruara të shoqërisë civile; (ii) organizatat që punojnë në fushën e të drejtave të grave; dhe (iii) OJF-të me përvojë në përfitimin e mbështetjes financiare dhe monitorimin e llogaridhënies lidhur me përdorimin e saj. Gjithashtu, u zhvilluan intervista të thelluara me përfaqësues të OJF-ve, zyrtarë publikë dhe ekspertë të sektorit bankar të specializuar në kërkesat kundër pastrimit të parave. Në total, 80 aktorë kontribuuan në hartimin e raportit përmes grupeve të fokusit dhe intervistave. Përveç kësaj, Partnerët Shqipëri zhvilloi një anketim me 76 OJF, i fokusuar ekskluzivisht në përvojat e tyre me procedurat e regjistrimit dhe riregjistrimit. Të dhëna të mëtejshme u siguruan përmes komunikimit të vazhdueshëm me OJF-të që përfitojnë shërbime nga

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile. Ky kombinim metodash mundësoi krahasimin e kuadrit formal me përvojat praktike të OJF-ve dhe aktorëve të tjerë përkatës.

Të dhëna shtesë sasiore u mblodhën përmes kërkesave për të drejtën e informimit. Partners Albania paraqiti 90 kërkesa pranë autoriteteve publike përkatëse, përfshirë ministritë, bashkitë, institucionet e pavarura dhe organet përgjegjëse për OJF-të. Përgjigje u morën nga 62 autoritete, që përfaqësojnë një normë përgjigjeje prej rreth 68%. Sipas Ligjit për të Drejtën e Informimit, autoritetet publike janë të detyruara të vënë në dispozicion informacionin që përmbajnë dokumentet zyrtare ekzistuese, por nuk kanë detyrimin të përpilojnë ose konsolidojnë të dhëna nga burime të ndryshme në përgjigje të një kërkese. Për rrjedhojë, disa autoritete iu referuan informacionit të publikuar në faqet e tyre të internetit, në vend që t'u përgjigjeshin drejtpërdrejt pyetjeve të parashtruara. Për shembull, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve deklaroi se të dhënat e kërkuara ishin të disponueshme në faqen e saj të internetit, megjithëse në seksionin e të dhënave të hapura nuk u identifikua informacion përkatës. Institucione të tjera deklaruan se nuk mund të nxirrnin informacionin që kërkonte ndërthurjen e disa kritereve të ndryshme. Shumica e ministrive dhanë përgjigje të shkurtra ose të pjesshme, duke trajtuar vetëm një pjesë të kufizuar të pyetjeve të parashtruara. Kjo evidenton mangësi në disponueshmërinë e të dhënave, administrimin institucional të dokumentacionit dhe kapacitetin për të ofruar informacion gjithëpërfshirës mbi bashkëpunimin me OJF-të dhe mbështetjen ndaj tyre.

Mungesa e të dhënave zyrtare ose vonesat në publikimin e tyre mbeten një sfidë e rëndësishme në të gjitha fushat e monitorimit. Mungojnë veçanërisht të dhëna gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme publikisht mbi numrin e OJF-ve aktive dhe punonjësve të tyre, kontributin e tyre financiar në ekonomi, numrin e vullnetarëve dhe orët e angazhimit vullnetar, si dhe llojet dhe vëllimin e shërbimeve që ato ofrojnë. Këto boshllëqe vështirësojnë raportimin e saktë, hartimin e politikave të bazuara në të dhëna dhe zhvillimin e strategjive efektive të advokimit.